



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS**

RAPORT AUDITIMI PERFORMANCE

**“REZERVAT MATERIALE TË SHTETIT NË SHËRBIM TË
QYTETARIT”**



Tiranë 2023

P Ë R M B A J T J A

1. PROBLEMI SOCIAL DHE RËNDËSIA E AUDIMIT.....	4
1.1 Konteksti i problemit social.....	4
1.2 Rëndësia e auditimit të performancës.....	5
1.3 Auditime të mëparshme apo aktuale në këtë fushë.....	5
2. SUBJEKTI/ET NËN AUDITIM.....	5
2.1 Hyrje në subjektet nën auditim.....	5
2.2 Baza ligjore që rregullon çështjen nën auditim.....	8
2.3 Rëndësia e produkteve të subjektit.....	9
2.4 Pesha në buxhet.....	10
2.5 Përkufizimet dhe terminologjia.....	12
2.6 Skema e analizës së programit auditues.....	13
2.7 Feedback-u i subjektit gjatë auditimit.....	13
3. DETAJET E AUDITIMIT.....	14
3.1 Vlerësimi i risqeve të aktiviteteve të subjektit.....	14
3.2 Objektivi i auditimit.....	15
3.3 Pyetjet e auditimit.....	16
3.4 Fushëveprimi i auditimit.....	17
4. SHITJELLIMI I PYETJEVE AUDITUESE.....	17
4.1.1 A është i mjaftueshëm dhe i përshtatshëm kuadri ligjor dhe rregullator?	17
4.1.2 A janë të qarta rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve të përfshira?	24
4.2.1 A i ka shërbyer mekanizmi i ngritur miradministrimit të rezervës materiale të shtetit?	34
4.2.2 A ka funksionuar sistemi i raportimit, monitorimit dhe koordinimit mes institucioneve të përfshira?	51
5. PËRMBLEDHJE.....	54

Lista e shkurtimeve

Nr.	Shkurtimi	Emërtimi i Plotë
1	RSH	Republika e Shqipërisë
2	BE	Bashkimi Evropian
3	KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
4	VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
5	MM	Ministria e Mbrojtjes
6	SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
7	MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
8	MB	Ministria e Brendshme
9	DPRMSH	Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit
10	DRRMSH	Drejtoria Rajonale e Rezervave Materiale të Shtetit
11	AKMC	Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile
12	KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
13	NJVQV	Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore
14	FSHZH	Fondi Shqiptar i Zhvillimit
15	FA	Forcat e Armatosura
16	INTOSAI	The International Organization of Supreme Audit Institutions
17	EUROSAI	The European Organisation of Supreme Audit Institutions
18	SËOT	Fuqitë, Dobësitë, Shanset, Kërcënimet
19	KNEC	Komiteti Ndërmintrosor i Emergjencave Civile
20	DAP	Departamenti i Administratës Publike
21	RMSH	Rezerva materiale e shtetit
22	PKEC	Plani Kombëtar i Emergjencave Civile

1. PROBLEMI SOCIAL DHE RËNDËSIA E AUDIMIT

1.1 Konteksti i Problemit Social

Mbrojtja e jetës dhe shëndetit të qytetarëve është një detyrim ligjor i shtetit, i cili sanksionohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe akte të tjera ligjore. Në situatat e emergjencës civile, rezervat materiale të shtetit janë një instrument që kontribuon në funksionimin e “shtetit të mirë”, i cili në kushte jo të zakonshme i siguron dhe garanton jetën dhe shëndetin e qytetarit. Rezerva materiale e shtetit krijohet për të ndërhyrë në mënyrë operative, për mbrojtjen e popullsisë, të ekonomisë dhe mbrojtjen e vendit, në situata të gjendjes së jashtëzakonshme, gjendjes së emergjencës civile, veprimeve terroriste, veprimeve ushtarake (në gjendje lufte), të cilat sjellin dëme të menjëhershme e të rënda për jetën, për shëndetin e popullatës dhe të gjësë së gjallë, për pasurinë, për trashëgiminë kulturore dhe për mjedisin. Ato përdoren edhe për dhënien e ndihmave humanitare, në përputhje me normat e së drejtës ndërkombëtare.

Rezerva materiale e shtetit në raste të mungesës apo krizave për mallra, të cilat kanë një impakt të rëndësishëm në jetën e qytetarëve, shërben si garantor, duke qenë se Shqipëria është një vend i varur nga importet e produkteve e për rrjedhojë e ekspozuar ndaj faktorëve të jashtëm të tregut.

Goditjet e njëpasnjëshme me pasoja shkatërruese që pësoi Shqipëria nga tërmeti i fuqishëm në fund të vitit 2019, pandemia globale e COVID-19 në fillim të vitit 2020, si dhe konfliktet në arenën ndërkombëtare, kanë evidentuar rëndësinë e rezervës materiale të shtetit.

Nëse i referohemi historikut të krijimit të rezervës materiale në vend, ajo daton prej vitit 1946 në formën e një institucioni në varësi të drejtpërdrejtë të ish Komisionit të Planit të Shtetit, ndërsa administrimi i mallrave rezervë kombëtare realizohej nga Këshilli i Ministrave nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave të Shtetit. Në varësi të hapave që ndërmerrnin qeveritë, detyrat e rezervës së shtetit kanë ndryshuar gjatë viteve, sipas vizionit politik dhe prioriteteve të dhëna përgjatë periudhave. Në vitin 2008, Rezerva Materiale e Shtetit filloi të funksionojë me një ligj organik të veçantë, Ligjin nr. 9900, datë 10.04.2008, “Për Rezervat Materiale të Shtetit”, i ndryshuar, VKM-në nr. 1128, datë 05.08.2008 “Për administrimin e mallrave rezerve shtetërore” dhe aktet nënligjore në zbatim të tyre. Qëllimi i ligjit është vendosja e bazave juridike dhe administrative për rregullimin e marrëdhënieve që lindin, ekzistojnë dhe shuhen gjatë administrimit, mirëmbajtjes dhe kontrollit të pronësisë në rezervat materiale të shtetit.

Pjesë e rëndësishme e zinxhirit të institucioneve shtetërore, të cilat garantojnë këto të drejta është Drejtoria e Përgjithshme e Rezervës Materiale të Shtetit (DPRMSH) dhe institucionet e saj të varësisë të cilat administrojnë rezervën materiale të shtetit. Infrastruktura e trashëguar për rezervën materiale luan rol të rëndësishëm në ruajtjen e shpërndarjen në kohën e duhur të mallrave, në situatat e gjendjes së jashtëzakonshme dhe emergjencës civile. Shtrirja e gjerë gjeografike në terren dhe mungesa e vëmendjes në drejtim të saj, ka sjellë për pasojë dëmtimin e kësaj infrastrukture. Sipas raportimeve në media, një pjesë e saj ka qenë objekt i veprimtarive të paligjshme, gjatë viteve të fundit.

Misioni primar i rezervës materiale të shtetit është garantimi i listës së mallrave të përcaktuar dhe përgjigjja e shpejtë ndaj qytetarit në situatat e parashikuara. Përfshirja e institucioneve që garantojnë rezervën materiale të shtetit në aktivitete dytësore, zhvendos fokusin drejt tyre dhe rrezikon përmbushjen e misionit për të cilin janë krijuar. Një qeverisje e mirë nëpërmjet institucioneve dhe instrumenteve që përdor, garanton jetën, shëndetin dhe përmirëson cilësinë e jetës së qytetarëve të vet.

1.2 Rëndësia e auditimit të performancës

Auditimet e performancës vlerësojnë nëse synimet e politikave dhe skemat qeverisëse lidhen me problemet reale të shoqërisë dhe shqetësimet e palëve të interesit, duke dhënë një informacion shumë më të gjerë mbi ecurinë e të gjithë projekteve dhe programeve në entet publike të audituara. Këto auditime kryhen duke u bazuar tek Standardet Ndërkombëtare ISSAI dhe Udhëzuesi i Auditimit të Performancës (ISSAI 300, 3000, 3100, 3200, 5100 dhe 5200), Manuali i Auditimit të Departamentit të Performancës, Indikatorët e Performancës sipas praktikave më të mira audituese, të cilat shërbejnë si udhërrëfyes për konceptimin, planifikimin, kryerjen, konkludimin dhe ndjekjen e rekomandimeve të auditimit të performancës. Këto dokumente përmbajnë një numër udhëzimesh dhe informacionesh që marrin në konsideratë kushtet specifike dhe karakteristikat e çdo auditimi performance. Kontrolli i Lartë i Shtetit, duke synuar realizimin e misionit të tij, si institucion që ofron një ekspertizë të pavarur në ndihmë të një menaxhimi sa më të përgjegjshëm në shërbim të qytetarëve, jep një informacion shumë më të gjerë mbi ecurinë e të gjitha projekteve dhe programeve të institucioneve dhe enteve publike të audituara. Nëpërmjet auditimit të performancës synohet të analizohet ekonomiciteti, eficientia dhe efektiviteti i programeve të ekzekutivit.

Në linjë me prioritetet e përcaktuara në Strategjinë e Zhvillimit të KLSH-së 2023-2022, miratuar me Vendimin nr. 247 datë 29.12.2022 të Kryetarit, KLSH ndërmori auditimin “Rezervat materiale të shtetit në shërbim të qytetarit”, duke e konsideruar si një ndër çështjet që garanton sigurinë e qytetarëve në situata jo të jashtëzakonshme. KLSH nëpërmjet këtij auditimi synon të paraqesë situatën aktuale në lidhje me politikën për krijimin, ruajtjen dhe administrimin e rezervave materiale të shtetit, si dhe efektivitetin e mekanizmit të ngritur në funksion të zbatimit të tyre. Në përfundim do të jepen rekomandimet përkatëse për të përmirësuar situatën aty ku është e mundur.

1.3 Auditime të mëparshme apo aktuale në këtë fushë

Kontrolli i Lartë i Shtetit, në veprimtarinë e tij audituese gjatë viteve të fundit i ka kushtuar një rëndësi gjithmonë e më të madhe auditimit të veprimtarisë së institucioneve qendrore dhe atyre vendore sa i përket mbrojtjes dhe garancisë së jetës së qytetarëve në kushtet e zhvillimit jo të qëndrueshëm të ekonomisë diktuar nga fatkeqësitë dhe situatat e emergjencave.

Kontrolli i Lartë i Shtetit, gjatë vitit 2017, ka realizuar auditim në Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit, Tiranë me temë: “Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë”, për periudhën prej datës 01.01.2014 deri në datën 31.12.2017.

Gjithashtu gjatë vitit 2022, KLSH ka përfunduar auditimin “Mbi Përputhshmërinë” në Ministrinë e Mbrojtjes për periudhën nga data 01.09.2018 deri me datë 30.06.2021. Gjetjet dhe konkluzionet e dokumentuara për këto auditime janë publikuar në faqen zyrtare të institucionit.


1. SUBJEKTET NËN AUDITIM

2.1 Hyrje në subjektet nën auditim

Subjektet që do të përfshihen në këtë auditim janë:

1. Ministria e Mbrojtjes
2. Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit me drejtoritë rajonale të varësisë:
 - Drejtoria Rajonale e Rezervës Materiale të Shtetit, Tiranë
 - Drejtoria Rajonale e Rezervës Materiale të Shtetit, Dibër
 - Drejtoria Rajonale e Rezervës Materiale të Shtetit, Shkodër
 - Drejtoria Rajonale e Rezervës Materiale të Shtetit, Fier
 - Drejtoria Rajonale e Rezervës Materiale të Shtetit, Korçë

Fig.1 Skema e varësisë së subjekteve



Burimi: Grupi i Auditimit

Ministria e Mbrojtjes

- ✓ Ministria e Mbrojtjes ka për mision hartimin dhe zbatimin e politikave të përgjithshme shtetërore të sigurisë dhe të mbrojtjes së vendit në përputhje me Kushtetutën, Strategjinë e Sigurisë, Organizatën e Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO), Strategjinë Ushtarake dhe legjislacionin në fuqi në Republikës së Shqipërisë. Ajo përbëhet nga administrata e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabi i Përgjithshëm i FA.¹
- ✓ Ministria e Mbrojtjes në fushën e përgjegjësisë shtetërore planifikon e përballon emergjencat civile dhe vendos bazën juridike dhe administrative për rregullimin e marrëdhënieve që lindin, ekzistojnë dhe shuhen gjatë administrimit, mirëmbajtjes e kontrollit të pronësisë në rezervat materiale të shtetit.²

Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit

Ligji nr.9900 datë 10.04.2008 “Për rezervat materiale të shtetit”, ka si qëllim të vendosë bazat juridike dhe administrative për rregullimin e marrëdhënieve që lindin, ekzistojnë dhe shuhen gjatë administrimit, mirëmbajtjes dhe kontrollit të pronësisë në rezervat materiale të shtetit, në Republikën e Shqipërisë, si dhe përcakton përbërjen e rezervave materiale të shtetit, administrimin e tyre.

¹ <https://www.mod.gov.al/ministria/misioni>

² Vendim nr. 605 datë 20.10.2021 Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Mbrojtjes

-Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit, si më poshtë:

- ✓ Drejtorja e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit kryen administrimin e RMSH dhe përgjigjet për drejtimin dhe kontrollin e veprimtarisë administrative të degëve të saj rajonale.
- ✓ Drejtorja e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit është institucion qendror, që financohet nga Buxheti i Shtetit dhe varet nga ministri, organizohet në dy nivele: në atë qendror dhe rajonal.

-Drejtori i Përgjithshëm përfaqëson Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit. Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorit të Përgjithshëm:

- ✓ zbaton dhe administron buxhetin e miratuar të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit;
- ✓ administron fondin e rezervave materiale të shtetit, të planifikuar në buxhetin vjetor të institucionit, si zë më vete;
- ✓ bashkërendon veprimtarinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit me organet qendrore dhe organet e tjera shtetërore në fushën e rezervave materiale të shtetit;
- ✓ siguron vendvendosjen e rezervave materiale të shtetit;
- ✓ siguron krijimin dhe administrimin e rezervave materiale të shtetit;
- ✓ siguron kontakte me organe homologe dhe organizata të ndryshme, të huaja, për zgjidhjen efektive të problemeve në fushën e rezervave materiale të shtetit, si dhe veprimtari të tjera, për plotësimin e detyrave;
- ✓ siguron drejtimin ekonomiko-financiar të degëve rajonale dhe bashkërendimin e veprimtarisë së tyre në rastet e emergjencave civile apo të situatave të veçanta³.

Drejtoritë Rajonale të Rezervave Materiale të Shtetit

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- ✓ administrojnë mallra rezervë shtetërore, të konfiskuara, të sekuestruara, në ruajtje e ndihmë humanitare;
- ✓ marrin masa për miradministrimin e vlerave materiale e monetare, pritjen , shkarkimin, transportin e ndihmave të akorduara;
- ✓ propozojnë masa për përmirësimin e kapaciteteve strehuese, të strukturës së mallrave rezervë shtetërore sipas detyrave që i caktohen;
- ✓ janë përgjegjëse për ruajtjen e sekretit të gjendjes së mallrave dhe përpilimin e evidencave periodike për të cilat informon DPRSHM, për lëvizjen dhe gjendjen e mallrave;
- ✓ zbatojnë rregullat e marrjes në dorëzim, administrimin dhe shitjen e mallrave të sekuestruara, për kundërvajtje administrative si dhe për kontrabandë;
- ✓ marrin masa për shfrytëzimin e plotë të mekanizmave të mjeteve të transportit, për rritjen e efektivitetit të tyre;
- ✓ zbatojnë rregullat e ruajtjes së objekteve rezervë shtetërore dhe për masat e marra në ruajtjen e objekteve dhe mbrojtjen nga zjarri, sigurimin teknik dhe trajnimin e punonjësve.

³ Ligji nr. 9990, datë 10.04.2008 "Për rezervat materiale të shtetit", i ndryshuar.

1.2 Baza ligjore që rregullon çështjen nën auditim

2.2.1 Kriteret politike:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
- Ligji nr. 9990, datë 10.04.2008 "Për rezervat materiale të shtetit", i ndryshuar.
- Direktivat e Ministrisë së Mbrojtjes 2019, 2020, 2021, 2022.
- VKM Nr.605, datë 20.10.2021 "Për përcaktimin fushës së përgjegjësisë së Ministrisë së Mbrojtjes.
- VKM nr. 1128, datë 5.8.2008 "Për krijimin dhe administrimin e mallrave rezervë materiale shtetërore", i ndryshuar.
- VKM Nr.808 datë 12.12.2022 Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Mbrojtjes te Fondi Shqiptar i Zhvillimit, të pronës me emërtim Agjencia Lundër me vendndodhje në Lundër, Tiranë, zona kadastrale nr. 2529 dhe për një ndryshim në Vendimin nr.413 datë 11.07.2007 të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit", i ndryshuar.
- Të tjera.

2.2.2 Kriteret teknike dhe të monitorimit

- Ligji nr.9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar.
- Ligji nr.9874, datë 14.2.2008 "Për ankandin publik".
- VKM nr. 1128, datë 5.8.2008 "Për krijimin dhe administrimin e mallrave rezervë materiale shtetërore", i ndryshuar.
- VKM nr.816, datë 16.11.2016 "Për ngritjen e strukturave".
- VKM nr. 7, datë 18.12.2019 "Për përcaktimin e procedurave të administrimit dhe shpërndarjes së mallrave, ndihmë humanitare, dhuruar nga donatorë të huaj me destinacion të përcaktuar të një komuniteti".
- Urdhër i KM nr.63, datë 12.04.2018 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së DPRMSH dhe drejtorive rajonale , në varësi të saj".
- Udhëzim nr.1, datë 18.2.2015 "Për mënyrën e marrjes në dorëzim të mallrave nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit".
- Udhëzimi Nr.14, datë 01.12.2015, i Ministrit të Mbrojtjes "Për ankandin publik në Ministrinë e Mbrojtjes, Shtabin e Përgjithshëm, strukturat vartëse dhe në strukturat e FA".
- Udhëzim i përbashkët MB dhe MM Nr. 127 prot., Tiranë, më 11.01.2019, Nr.1 Prot. Tiranë , më 9.01.2019 "Për procedurat e kalimit të automjeteve dhe motomjeteve nga mjediset e drejtorive vendore të policisë kufitare dhe migracionit, tek drejtoritë rajonale të rezervave materiale të shtetit".
- Urdhër nr.376, datë 15.03.2019 "Për monitorimin e procedurave të nxjerrjes jashtë përdorimit dhe asgjësimit të mallrave të sekuestruara, konfiskuara dhe me afat të afërt skadence nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit".
- Udhëzim nr. 6, datë 17.5.2019 "Për procedurat që ndiqen për administrimin e automjeteve dhe motomjeteve që kalojnë në rezervat materiale të shtetit si pasojë e konfiskimit".
- Urdhër nr. 1054, datë 08.07. 2019 "Për miratimin e manualit për përcaktimin e peshës reale fizike të mjeteve motorike".
- Urdhër nr. 35, datë 12.03.2019 "Për miratimin e përshkrimeve të përgjithshme të punës të DPRMSH dhe drejtorive rajonale të varësisë".

- Urdhër nr.28, datë 24.02.2014 "Për zbatimin e Rregullores së Brendshme të DPRMSH dhe drejtorive rajonale të varësisë dhe miratimin e përshkrimit të punës të DRRMSH Tiranë".
- Urdhër nr.166 datë 08.02.2023, i Ministrit të Mbrojtjes, për zbatimin e Vendimit nr.808 datë 12.12.2022 Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Mbrojtjes te Fondi Shqiptar i Zhvillimit, të pronës me emërtim Agjencia Lundër me vendndodhje në Lundër, Tiranë.
- Urdhër nr. 1054, datë 08.07. 2019 "Për miratimin e manualit për përcaktimin e peshës reale fizike të mjeteve motorike".
- Të tjera.

1.3 Rëndësia e produkteve të subjektit

Ligji nr. 9990, datë 10.04.2008 "Për rezervat materiale të shtetit", i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, janë të rëndësishme pasi nëpërmjet vendosjes së bazave juridike dhe administrative, ndihmojnë në rregullimin e marrëdhënieve që lindin midis të gjithë aktorëve të përfshirë në proces, për të siguruar ndërhyrjen, në mënyrë operative, për mbrojtjen e popullsisë, të ekonomisë dhe mbrojtjen e vendit, në situata të gjendjes së jashtëzakonshme, gjendjes së emergjencës civile, duke shmangur dëmet e menjëhershme e të rënda për jetën, për shëndetin e popullatës, të pasurisë kombëtare, trashëgimisë kulturore, mjedisin, gjë e cila realizohet nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit dhe drejtorive rajonale.

Ministria e Mbrojtjes në cilësinë e organit politik bërës, harton, planifikon dhe zbaton politika të përgjithshme shtetërore, me synim garantimin e jetës dhe shëndetit të qytetarëve në situata jo të zakonshme.

Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit është institucion qendror, që financohet nga Buxheti i Shtetit dhe varet nga ministri, organizohet në dy nivele: në atë qendror dhe rajonal. Ajo kryen administrimin e rezervës materiale të shtetit dhe përgjigjet për drejtimin dhe kontrollin e veprimtarisë administrative të degëve të saj rajonale.

DPRMSH dhe drejtoritë rajonale janë pjesë e institucioneve në linjën e parë të veprimit dhe për rrjedhojë me rregullat organizative dhe administrative ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në përballimin e situatave të emergjencës civile dhe gjendjes së jashtëzakonshme.

2.4 Pesha në buxhet

Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit

DPRMSH është institucion qendror buxhetor në varësi të Ministrit të Mbrojtjes dhe organizohet në dy nivele: në atë qendror dhe rajonal. Ajo përgjigjet për drejtimin dhe kontrollin e veprimtarisë administrative të degëve të saj rajonale. Fondet për krijimin dhe administrimin e rezervave materiale të shtetit përballohen nga Buxheti i Shtetit nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme. Ndërkohë, drejtoritë rajonale nuk janë subjekte buxhetore me kod të veçantë por për veprimtarinë e tyre ato mbulohen nga institucioni i tyre epror, pra DPRMSH. Për periudhën vitet 2019-2022 fondet buxhetore të akorduara dhe niveli i realizimit të tyre paraqitet si më poshtë:


Tabela nr. 1 Fondet Buxhetore të DPRMSH

000/ lekë				
Nr.	Periudha	Buxheti i planifikuar	Buxheti i Realizuar	Realizimi në (%)
1	Viti 2019	117,226	97,102	83%
2	Viti 2020	109,620	93,182	85%
3	Viti 2021	123,771	99,247	80%
4	Viti 2022	227,360	208,969	92%
Shuma		577,977	498,500	86%

Burimi: DPRMSH, përpunuar nga grupi i auditimit

Ecuria e fondeve buxhetore të akorduara dhe atyre të shpenzuara nga ana e DPRMSH për periudhën paraqitet grafikisht si vijon.

Grafiku nr. 1



Burimi: Grupi i auditimit

Ministria e Mbrojtjes

Buxhetet totale vjetore të Ministrisë së Mbrojtjes për periudhën vitet 2019-2022 përfshijnë fondet për aparatit dhe institucionet në varësi të saj. Drejtoria e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit si njësi varësie e MM zë një pjesë të këtij buxheti. Buxhetet e realizuara në nivel ministrie sipas periudhës dhe pesha që fondet për DPRMSH zënë, paraqiten si vijon.

Tabela nr. 2 Fondet Buxhetore të Ministrisë së Mbrojtjes/DPRMSH


000/ lekë

Nr.	Periudha	Fonde Buxhetore gjithsej Ministria e Mbrojtjes	Fonde Buxhetore për DPRMSH	Pesha e DPRMSH në buxhetin e MM në (%)
		Fakt	Fakt	
1	Viti 2019	21,669,923	97,102	0.45%
2	Viti 2020	21,353,332	93,182	0.44%
3	Viti 2021	23,072,112	99,247	0.43%
4	Viti 2022	25,847,592	208,969	0.81%
Shuma		91,942,959	498,500	0.54%

Burimi: Ministria e Mbrojtjes, përpunuar nga grupi i auditimit

Ecuria e realizimit të fondeve buxhetore nga Ministria e Mbrojtjes në periudhën vitet 2019-2022 dhe pjesa që DPRMSH zë, paraqitet grafikisht si vijon.

Grafiku nr. 2



Burimi: Grupi i auditimit

2.5 Përkufizimet dhe terminologjia

Në kuptim të këtij auditimi, me termat e mëposhtëm nënkuptojmë:


- “Rezervat materiale të shtetit” janë lëndët e para, materialet, produktet e gatshme, prodhimet dhe mjetet e tjera të domosdoshme për depozitimin, mirëmbajtjen dhe ruajtjen e tyre.
- “Ministri” është ministri që mbulon fushën përkatëse.
- “Administrim” është lëvrimi, këmbimi, freskimi, plotësimi, ruajtja ose mirëmbajtja, heqja apo seleksionimi, huadhënia, blerja, shitja dhe çdo veprim tjetër, që mund të kryhet me rezervat materiale të shtetit.
- “Lëvrim” është dhënia, falas ose me pagesë, e rezervave materiale të shtetit.
- “Këmbim” është zëvendësimi i vlerës së pronës me një vlerë prone të një lloji tjetër, në cilësinë e kërkuar dhe në sasinë respektive, në varësi të vlerës monetare.
- “Zëvendësim” është zëvendësimi i vlerës së pronës me një vlerë të pronës të një lloji tjetër, të barabartë në cilësi, respektivisht në sasi.
- “Freskim” është zëvendësimi i rezervës materiale të shtetit për produktet, që janë në limitet e kohë ruajtjes ose kur ato paraqesin rrezik zhvlerësimi cilësor.
- “Ruajtje apo mirëmbajtje” është bashkësia e të gjithë veprimtarisë së administratës së rezervës dhe të agjentëve ekonomikë gjatë përkujdesjes për rezervat materiale të shtetit.
- “Limiti minimal i artikullit të rezervës materiale të shtetit” është sasia e caktuar, e shprehur në njësi matëse, nën të cilën nuk duhet të bjerë sasia e rezervës materiale të shtetit e këtij artikulli.
- “Gjendja orientuese e rezervës materiale të shtetit” janë sasi të artikullit, të shprehura në njësi matëse, të cilat vlerësohen si maksimale nga pikëpamja e nevojave në Republikën e Shqipërisë.
- “Plotësim” është shtimi i sasisë së rezervës materiale të shtetit deri në limitet maksimale, të përcaktuara për to.
- “Heqje” apo “seleksionim” është veprimi administrativ, që kryhet kur vlera e pronës nuk mund t’i shërbejë më qëllimit, sipas këtij ligji dhe është e domosdoshme të veprohet në përputhje me aktet nënligjore në fuqi.
- “Agjentë ekonomikë” janë personat juridikë, privatë ose publikë, të cilëve u besohet ruajtja dhe mirëmbajtja e rezervave materiale të shtetit, që kërkojnë kushte të veçanta ruajtjeje.
- “Huadhënie” është lënia në përdorim të përkohshëm dhe kthimi brenda afatit të caktuar.
- “Mallra ndihmë humanitare” janë të gjitha ato mallra, që i jepen shtetit shqiptar si ndihmë humanitare nga shtete, donatorë dhe individë, për rastet e situatave të përshkruara në nenin 3 të këtij ligji.
- “Mallra të konfiskuara” janë mjetet e punës, lëndët e para, materialet, karburantet, produktet e gatshme, vlerat e tjera materiale dhe të gjitha sendet, që kalojnë në pronësi të shtetit, me vendim të formës së prerë të organit kompetent, si rrjedhojë e kundërvajtjeve administrative, veprave penale apo si pasojë e parandalimit dhe goditjes së krimit të organizuar. Këto mallra administrohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2.6 Skema e analizës së programit auditues

Ky auditim do të fokusohet në analizimin e politikave për krijimin e rezervave materiale të shtetit, ruajtjen dhe administrimin me efektivitet të tyre, monitorimin si edhe rolin dhe përgjegjësitë që subjektet nën auditim kanë pasur duke u fokusuar veçanërisht në:

- Vizionin e Ministrisë së Mbrojtjes lidhur me rezervën materiale të shtetit;
- Hartimin e politikave që garantojnë qëndrueshmërinë e rezervës materiale të shtetit;
- Rolin dhe përgjegjësinë që kanë strukturat;
- Fondet buxhetore që dedikohen për rezervën materiale të shtetit;
- Koordinimi dhe bashkëpunimi midis institucioneve;
- Sistemin e raportimit dhe monitorimit të rezervës materiale të shtetit.

Fig.2 Skema e analizës së programit auditues



Burimi: Grupi i auditimit

2.7 Feedback-u i subjektit në fazën e terrenit

Gjatë fazës së terrenit, Ministria e Mbrojtjes, i është përgjigjur përgjithësisht në kohë, plotësimit të informacionit dhe dokumentacionit të kërkuar që lidhet me konfirmimin e të dhënave. Drejtoria e Përgjithshme e Rezervës Materiale të Shtetit si edhe Drejtoritë Rajonale Tiranë, Fier, Shkodër, Dibër dhe Korçë, gjatë fazës së terrenit i janë përgjigjur përgjithësisht në kohë plotësimit të informacionit të kërkuar nga grupi i auditimit për konfirmimin e të dhënave.

3. DETAJET E AUDITIMIT

3.1 Vlerësimi i risqeve të aktiviteteve të subjektit


Risqet e politikave dhe aktiviteteve të subjekteve të përfshira në këtë auditim, kanë të bëjnë me vështirësitë dhe pengesat që ato hasin në realizimin e detyrave dhe funksioneve të përcaktuara në kuadrin ligjor e rregullator në fuqi. Për të kryer analizën e riskut, jemi mbështetur në analizën SWOT duke marrë në konsideratë fuqitë, dobësitë, mundësitë dhe kërcënimet që paraqiten në veprimtarinë e subjekteve nën auditim, që lidhen me fushën e sigurisë kibernetike. Analiza SWOT është një kornizë që përdoret për të identifikuar dhe analizuar fuqitë, dobësitë, mundësitë dhe kërcënimet që paraqiten lidhur me çështjen që trajtohet. Analiza SWOT është e dizenuar për të ofruar një qasje realiste, të bazuar në fakte dhe të dhëna e cila përdor burime të brendshme dhe të jashtme dhe përdoret si një teknikë për të vlerësuar performancën, risqet dhe mundësitë potenciale për zhvillim dhe arritjen e objektivave. Për kryerjen e analizës grupi i auditimit ka përcaktuar objektivin që synohet të arrihet përmes këtij auditimi, ka mbledhur të dhëna dhe evidenca dhe ka bashkërenduar mendimet dhe konceptet e secilit prej anëtarëve të grupit.

U përzgjedh përdorimi i analizës SWOT nisur nga fakti që kjo analizë ofron mundësinë e një menaxhimi më efikas të një problemi kompleks siç është garantimi i rezervës materiale të shtetit në shërbim të qytetarit.

Duke iu referuar evidentimit të fuqive, dobësive, shanseve dhe kërcënimeve të paraqitur në analizën SWOT, grupi i auditimit ka bërë një ndarje dhe grupim të risqeve të veprimtarisë së institucioneve përkatëse, për të adresuar dhe ndarë faktorët e riskut sipas përkatësisë së tyre, brenda kontrollit dhe jashtë kontrollit menaxherial.

Gjithashtu është bërë edhe kategorizimi i tyre në strategjik, financiar, juridik dhe operacional.

Fig.3 Analiza SWOT



Burimi: Grupi i auditimit

Tabela. 3: Analiza e Riskut

Nr.	Risku i Subjektit	Kategorizimi i riskut	Niveli i Riskut
1	Përcaktimi jo i qartë i rolit, përgjegjësisë dhe detyrave funksionale të subjekteve në garantimin e rezervës materiale të shtetit.	Risk Strategjik	I lartë
2	Mungesa e përfshirjes së rezervës materiale të shtetit në dokumente strategjike.		I lartë
3	Tjetërsimi i aseteve.		I lartë
4	Mungesë analize për aktivitetin e rezervë s materiale të shtetit në dinamikën e zhvillimeve.		I mesëm
5	Mungesë e fondeve buxhetore për garantimin e rezervës materiale të shtetit sipas përcaktimeve të VKM-së Nr.1128, datë 05.08.2008 “Për administrimin e mallrave rezerve shtetërore”, i ndryshuar.	Risk Financiar	I lartë
6	Mungesë analize për planifikimin e fondeve buxhetore.		I mesëm
7	Mungesë e akteve ligjore dhe nënligjore dhe përditësimi i kuadrit rregullator.	Risk Rregullator dhe Juridik	I lartë
8	Qendërzim i proceseve të administrimit të rezervës materiale të shtetit.	Risk Operacional	I mesëm
9	Kufizim në përdorimin e infrastrukturës TIK..		I mesëm
10	Mungesë e sistemit të raportimit dhe monitorimit.		I mesëm
11	Mungesë e sistemit të ruajtjes dhe sigurisë së RMSH-ve		I lartë
12	Koordinim dhe bashkëveprim i dobët.		I mesëm


Burimi: Grupi i Auditimit

3.2 Objektivi i auditimit

Auditimi me temë “Rezerva materiale e shtetit në shërbim të qytetarit” ka si objektivi kryesor vlerësimin e politikave të ndërmarra nga institucionet përgjegjëse, efektivitetin e tyre në funksion të garantimit të rezervës materiale dhe miradministrimin e saj. Në këtë mënyrë do të synohet të sigurohet një vlerësim i paanshëm dhe objektivi nëse politikat e ndërmarra, rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve janë të qarta si dhe proceset administrative garantojnë miradministrimin e rezervës materiale të shtetit në përmbushje të misionit të tyre.

3.3 Pyetjet e auditimit

Fig.4 Piramida e pyetjeve audituese



3.4 Fushëveprimi i auditimit

Ky auditim do të ketë si fushëveprimi analizimin dhe dhënien e një opinionimi mbi politikën e ndërmarrë dhe miradministrimin e proceseve me synim garantimin e rezervës materiale të shtetit në shërbim të qytetarëve. Auditimi për shkak të kompleksitetit të tij do të ketë një qasje në nivel makro duke parë nga perspektiva e detyrimeve që subjektet kanë në lidhje me garantimin e rezervës materiale të shtetit.

Periodha e auditimit do të jetë 01.01.2019 deri më datë 28.02.2023. Gjatë këtij auditimi do të fokusohemi në mënyrë të veçantë në veprimtarinë e Ministrisë së Mbrojtjes, Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervës Materiale të Shtetit si edhe pesë Drejtorive Rajonale, përkatësisht Tiranë, Dibër, Korçë, Fier, Shkodër. Numri i lartë i subjekteve të përzgjedhur si edhe periodha e auditimit prej vitit 2019 është për të pasur një panoramë më të plotë lidhur me fokusin e auditimit në këndvështrimin e politikave të hartuara për rezervën materiale të shtetit dhe aktivitetit real që institucionet përgjegjëse ushtrojnë në funksion të përmbushjes së objektivave.

1. Shtjellimi i pyetjeve audituese

Pyetja Kryesore: A garantohen qytetarët nga rezerva materiale e shtetit ?

Mesazhi i auditimit

Institucionet përgjegjëse duhet të përdorin gjithë instrumentet në dispozicion për të përmbushur pritshmërinë e qytetarit lidhur me sigurinë që ato duhet të ofrojnë për jetën dhe shëndetin e tyre. Rezerva materiale e shtetit si një garanci për qytetarin, duhet të përmbushë plotësisht misionin për të cilin është krijuar. Kalimi nën përgjegjësinë e Ministrisë së Mbrojtjes, duhet të sjellë zhvillime pozitive, të cilat ti shërbejnë forcimit të rolit të saj. Orientimi i veprimtarisë së strukturave përgjegjëse, burimet njerëzore dhe financiare duhet të fokusohet drejt aktivitetit parësor për përbalimin e situatave të parashikuara. Asetet e trashëguara, pasuri kombëtare, duhet të administrohen për të qenë një vlerë e shtuar në rezervën materiale të shtetit. Parë nga perspektiva e zhvillimeve gjeopolitike, ndryshimeve klimaterike dhe demografike përmbushja e kufijve minimalë të përcaktuar të rezervës materiale e shtetit, duhet të jetë garanci për qytetarin.

4.1 A ka një vizion të qartë mbi rezervën materiale të shtetit?

4.1.1 A është i mjaftueshëm dhe i përshtatshëm kuadri ligjor dhe rregullator?

Vizioni strategjik i rezervës materiale

Rezervat e Shtetit janë krijuar në vitin 1946 dhe deri më sot, në mbështetje të misionit për mbrojtjen e vendit, jetës dhe shëndetit të qytetarëve, kanë ndryshuar disa herë, varësinë funksionale dhe administrimin, jo vetëm në varësi të politikave qeverisëse të sistemeve shoqërore që ka kaluar vendi ynë, por edhe të problematikave të krijuara në vijim.

Në vitin 2003, me Vendimin nr. 60 datë 23.01.2003 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime dhe një shtesë në Vendimin nr. 372, datë 25.07.1994 të Këshillit të Ministrave, për administrimin e mallrave kombëtare”, ndryshoi varësia e Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave nga Këshilli i Ministrave, tek Ministri i Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, mbi bazën e të cilit u rishikua misioni, mënyra e funksionimit dhe organizimi në tërësi i Rezervave Shtetërore.

Pas vitit 2008, me VKM nr. 942, datë 9.10.2013 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Punëve të Brendshme”, varësia e institucioneve që administrojnë rezervat materiale të shtetit kaloi te Ministria e Punëve të Brendshme.

Me Vendimin nr. 501, datë 13.09.2017, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar, varësia institucionale e rezervave materiale të shtetit kaloi te Ministria e Mbrojtjes.

Pavarësisht ndryshimit të varësisë institucionale, nga viti 2008 deri më sot, Rezerva Materiale e Shtetit funksionon me një ligj organik të veçantë, Ligjin nr. 9900, datë 10.04.2008, “Për Rezervat Materiale të Shtetit”, të ndryshuar, VKM-në nr.1128, datë 05.08.2008 “Për administrimin e mallrave rezerve shtetërore”, të ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tyre.

Qëllimi i ligjit është vendosja e bazave juridike dhe administrative për rregullimin e marrëdhënieve që lindin, ekzistojnë dhe shuhen gjatë administrimit, mirëmbajtjes dhe kontrollit të pronësisë në rezervat materiale të shtetit.

Rezervat materiale të shtetit krijohen për të ndërhyrë, në mënyrë operative, për mbrojtjen e popullsisë, të ekonomisë dhe mbrojtjen e vendit, në situata të gjendjes së jashtëzakonshme, gjendjes së emergjencës civile, veprimeve terroriste, veprimeve ushtarake (në gjendje lufte), të cilat sjellin dëme të menjëhershme e të rënda për jetën, për shëndetin e popullatës dhe të gjësë së gjallë, për pasurinë, për trashëgiminë kulturore, mjedisin, si dhe për dhënien e ndihmave humanitare, në përputhje me normat e së drejtës ndërkombëtare.

Angazhimi i vendit tonë drejt integritit evropian kërkon qeverisje të mirë e cila nëpërmjet programeve qeverisëse të konceptuara si plane të kujdesshme veprimi, me synim realizimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, me institucionet dhe instrumentet e vetë, të garantojë dhe përmirësojë cilësinë e jetës së qytetarëve. Për këtë duhet të synohet:

-ndërtimi i qëndrueshmërisë së personave në situata të pambrojtura dhe zvogëlimi i ekspozimit dhe cenueshmërisë së tyre ndaj ngjarjeve ekstreme të lidhura me klimën, goditjet dhe fatkeqësitë e tjera ekonomike, sociale dhe mjedisore, si dhe katastrofat.⁴

-sigurimi i mobilizimit domethënës të të ardhurave nga një sërë burimesh, duke përfshirë zgjerimin e bashkëpunimit për zhvillim, në mënyrë që të sigurohen mjete të përshtatshme dhe të parashikueshme për vendet në zhvillim.⁵

-miratimi i masave për të siguruar funksionimin e duhur të tregjeve të mallrave ushqimore dhe derivateve të tyre dhe për të lehtësuar aksesin në kohë tek informacionet e tregut, përfshirë rezervat e ushqimit, në mënyrë që të ndihmohet kufizimi i luhatshmërisë ekstreme të çmimeve të ushqimeve.⁶

-miratimi dhe zbatimi i politikave dhe planeve të integruara drejt përfshirjes, efikasitetit të burimeve, zbutjes dhe përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike, elasticitetit ndaj fatkeqësive, si dhe hartimi dhe zbatimi në përputhje me Kornizën Sendai për Uljen e Rrezikut nga Fatkeqësitë 2015-2030 i menaxhimit tërësor të rrezikut nga fatkeqësitë në të gjitha nivelet.⁷

Referuar objektivave të mësipërme duhet të orientohen Strategjitë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, si edhe strategjitë sektoriale të institucioneve qendrore, sipas fushave të përgjegjësisë, lidhur me rezervat materiale të shtetit.

Në zbatim të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020 (SKZHI 2015-2020) vizioni i të cilës ka qenë “Për një demokraci në forcim në rrugën drejt integritit evropian, me ekonomi konkurruese, të stabilizuar dhe të qëndrueshme, konsolidimi i qeverisjes së mirë, demokracisë dhe shtetit të së drejtës përcakton kuadrin ligjor dhe rregullator mirë-funksionues për qytetarët dhe mishëron nocionet kyçe të saj, të promovuar nga institucionet ndërkombëtare”, Ministria e Punëve të Brendshme dhe institucionet e saj të varësisë, kanë qenë institucione përgjegjëse për administrimin e RMSH dhe përgatitjen për rastet urgjente, fatkeqësitë dhe emergjencat civile. Çdo strategji sektoriale e kësaj ministrie për RMSH, duhet të synonte realizimin e këtij vizioni. Me VKM nr.702, datë 26.8.2015⁸, Ministria e Punëve të Brendshme miratoi “Strategjinë Kombëtare Sektoriale të Rendit Publik 2014-2020”, ku një ndër sfidat kryesore kishte lidhje me uljen e riskut të fatkeqësive dhe menaxhimin e mbrojtjes civile, në përputhje me Kornizën Sendai për Uljen e Rrezikut nga Fatkeqësitë 2015-2030⁹.

⁴Objektivi Nr.1 Zhdukja e varfërisë në të gjitha format e saj në gjithë botën.

⁵Objektivi Nr. 2Eliminimi i urisë, arritja e sigurisë ushqimore dhe përmirësimi i ushqyerjes, si dhe nxitja e bujqësisë së qëndrueshme.

⁶Objektivi Nr. 16Promovimi i shoqërive paqësore dhe përfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, ofrim i aksesit në drejtësi për të gjithë dhe ndërtimi i institucioneve efektive, llogaridhënëse dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet

⁷Korniza Sendai për Uljen e Rrezikut nga Fatkeqësitë 2015-2030.

⁸VKM nr.702, datë 26.8.2015⁸, “Për miratimin e Strategjinë Kombëtare Sektoriale të Rendit Publik 2014-2020”.

⁹Korniza Sendai për Uljen e Rrezikut nga Fatkeqësitë 2015-2030, i menaxhimit tërësor të rrezikut nga fatkeqësitë në të gjitha nivelet.

Ministria e Punëve të Brendshme, nuk ka pasur ndonjë vizion të detajuar në plane konkrete veprimi lidhur me administrimin e RMSH, ndërkohë që nuk hartoi dhe Strategjinë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë (SKZRF), planifikuar në SKZHI 2015-2020.

Edhe pse ndodhi ndryshimi i përgjegjësisë administrative të DPRMSH-së, në vitin 2018 me VKM Nr.9, datë 12.01.2018 “Për një ndryshim në Vendimin nr. 501, datë 13.09.2017, të KM “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Mbrojtjes”¹⁰, si MPB po ashtu dhe MM, nuk bënë ndonjë propozim për rishikimin e dokumentit SKZHI 2015-2020, me qëllim rishikimin dhe hartimin e politikave për administrimin e RMSH, për më tepër që vitet 2019, 2020, 2021 ishin vite të fatkeqësive natyrore dhe emergjencave civile. Kjo strategji nuk u rishikua me ndonjë akt nënligjor.

Me miratimin e Ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, në zbatim të VKM-së nr. 628, datë 25.09.2019 “Për miratimin e dokumentit të rishikimit të Strategjisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë”, u rishikua Strategjia e Ministrisë së Mbrojtjes¹¹, si dhe u përcaktuan direktivat e saj për vitet 2019-2022, me prioritetet përkatëse lidhur me mbrojtjen civile, si:

- Ngritja e një sistemi efektiv për menaxhimin e emergjencave civile dhe ndihma ndaj komunitetit;
- Konsolidimi i kuadrit ligjor për rezervat materiale të shtetit dhe mbështetja me mallra në emergjenca civile;
- Përmirësimi, modernizimi dhe ngritja e strukturave dhe kapaciteteve operacionale reaguese për përballimin e emergjencave civile, bazuar në nevojat tona, eksperiencën e vendeve të tjera, shtimin dhe përmirësimin e kapaciteteve magazinuese, me qëllim realizimin e ndihmës ndaj popullatës së prekur nga fatkeqësitë e ndryshme natyrore në çdo kohë dhe nevojë, etj.

Direktivat e MM për vitet 2019-2022, ku përfshihen dhe rezervat materiale të shtetit, më tepër fokusohen në funksion të zhvillimit të kapaciteteve magazinuese por të pa detajuara në plane konkrete veprimi.

Një nga dokumentet kyçe që zbërthen vizionin strategjik në aktivitete praktike dhe përcakton organizimin e sistemit kombëtar të menaxhimit të mbrojtjes civile dhe përgjegjësitë e ndërveprimit në nivel vendor, kombëtar e rajonal është Plani Kombëtar i Emergjencave Civile, i cili është dhe një mjet koordinimi për menaxhimin gjithëpërfshirës dhe efektiv të sistemit të Mbrojtjes Civile në Shqipëri.

Ministria e Mbrojtjes me institucionet e saj të varësisë zbatojnë dhe sot PKEC-04, të miratuar me VKM nr. 835, datë 3 Dhjetor 2004¹², kohë kur DPRMSH ka qenë nën varësinë e Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit¹³.

Plani i ri Kombëtar i Emergjencave Civile është prezantuar si draft paraprak në muajin Gusht të vitit 2022, por orientimi i prioriteteve përsëri nga FA dhe strukturat ushtarake, rrishtet të krijojë problematika në zbatimin e tij¹⁴. Në këtë dokument rezerva materiale e shtetit nuk është vlerësuar si pjesë integrale e këtij plani.

Një nga shtatë objektivat e Kuadrit Sendai¹⁵ për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2015–2030, ka qenë hartimi dhe zbatimi i strategjive kombëtare dhe vendore për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, gjë e cila u realizua me VKM-në nr. 94, datë 22.02.2023 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2023-2030”, jashtë afateve kohore të parashikuara. Deri në miratimin e dokumentit të mësipërm, në asnjë dokument tjetër, nuk janë përfshirë aktivitetet e zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë në të gjithë sektorët, përfshi këtu dhe

¹⁰VKM Nr.9, datë 12.01.2018, “Për një ndryshim në Vendimin nr. 501, datë 13.09.2017, të KM “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Mbrojtjes”

¹¹ <http://qbz.gov.al/eli/vendim/2019/09/25/628>

¹² VKM nr. 835, dt. 3.12. 2004 “Për miratimin e PKEC-04”.

¹³VKM nr. 60 datë 23.01.2003 “Për disa ndryshime dhe një shtesë në Vendimin nr. 372, datë 25.07.1994 të Këshillit të Ministrave, për administrimin e mallrave kombëtare”.

¹⁴ Përgjigje pyetëso

¹⁵ Sendai Framework for Disaster Risk Reduction

RMSH.¹⁶ Në bazën ligjore dhe planet e veprimit të SKZRF 2023-2030, nuk përfshihen RMSH dhe DPRMSH-ja.

Në zbatim të Urdhrit nr. 157, datë 30.12.2021 të Kryeministrit “Për hartimin e SKZHI 2021-2030”, dhe programit të saj qeverisë, qeveria shqiptare, me VKM-në nr. 88, datë 22.2.2023 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022–2030”, ka miratuar këtë strategji, jashtë afateve ligjore të parashikuara dhe pa plane konkrete veprimi lidhur me menaxhimin e RMSH në situata të fatkeqësive natyrore dhe emergjencave civile. Mungesa e këtij dokumenti strategjik ka bërë që RMSH të mos trajtohen në strategjitë sektoriale të MM dhe kjo e fundit, si institucion përgjegjës për politikat shtetërore të sigurisë dhe mbrojtjes së vendit, nuk ka një vizion të qartë për RMSH, për garantimin e nevojave të popullsisë në situata normale dhe të emergjencave civile.

Kuadri ligjor dhe rregullator për rezervën materiale

Kuadri rregullator për administrimin e RMSH, për periudhën nën auditim bazohet në Ligjin nr. 9990, datë 10.04.2008 "Për rezervat materiale të shtetit", të ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Zhvillimet e fundit për mbrojtjen civile kanë diktuar nevojën për rishikimin e tij. Sipas Urdhrit nr. 183, datë 12.02.2020 të Ministrit të Mbrojtjes, “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9990, datë 10.04.2008 “Për rezervat Materiale të Shtetit”, është ngritur grupi i punës, i cili nuk ka përfunduar ende shqyrtimin e mendimeve të dhëna nga ministritë e linjës duke e lënë situatën pezull mbi këtë projektligj. Përfaqësuesit e DPRMSH-së, si pjesë e grupit të punës, shprehen se drejtoria nuk disponon një projekt akt apo draft të zyrtarizuar si akt propozues nga institucioni. Pra në këtë rast institucioni kryesor për rezervën materiale të shtetit është lënë jashtë procesit në fazën e parë të draftimit të projektligjit. DPRMSH është njohur me projektligjin dhe relacionin shoqërues në vitin 2021, i cili është përcjellë në rrugë elektronike në kuadër të trajtimit nga ana e tyre të mendimeve të dhëna nga Ministria e Brendshme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Drejtësisë për projektligjin¹⁷.

Në aspektin ligjor, Projektligji “Për rezervat materiale të shtetit”, vijon të hasë pengesa në miratimin e tij, për shkak të mbivendosjes me Ligjin Nr.34/2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara”, si më poshtë vijon: “Sipas Ligjit nr.34/2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara”, i ndryshuar, institucioni përgjegjës për administrimin dhe/ose përdorimin e pasurive të konfiskuara është Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e Konfiskuara, institucion në varësi të Ministrisë së Drejtësisë. Gjithashtu në pikën 4, të nenit 7, të Ligjit nr.34/2019, të ardhurat e përfituara nga tjetërsimi i pasurive të konfiskuara shkojnë në, buxhetin e shtetit, fondin e posaçëm për parandalimin e kriminalitetit dhe llogarinë e Agjencisë së lartë përmendur. Kësisoj përfshirja e konfiskimeve si një burim për krijimin e rezervave materiale të shtetit bie ndesh dhe krijon mbivendosje me Ligjin nr.34/2019”. (Trajtim më i zgjeruar në Pyetjen Audituese nr. 4.1.2 në vijim).

Referuar bazës ligjore ekzistuese si dhe përgjigjet e pyetësorëve të DPRMSH dhe DRRMSH rezulton se, me miratimin e Ligjit Nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, janë shfaqur disa problematika, përkatësisht:

1. Në pikën 3.a) të nenit 10 të Ligjit nr. 9900/2008 përcaktohet se mallrat rezervë të grupit C lëvrohen me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Rezervave Materiale të Shtetit kur shpallet gjendje e EC të shtetit ose me kërkesë të Prefektit të qarkut, ndërkohë që në pikën II). të nenit 28 të Ligjit Nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, citohet: “Prefekti i qarkut i drejton kërkesë për mbështetje AKMC-së, sipas kërkesës së bërë nga bashkitë”. Lëvrimi i mallrave në situatat e sipërpërmendura në kohë reale vështirësohet,¹⁸ pasi DPRMSH, AKMC dhe Prefekti, janë aktorë

¹⁶ “Strategjia kombëtare për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë (SKZRF2023-2030)”.

¹⁷ Përgjigjet e pyetësorëve të DPRMSH

¹⁸ E konfirmuar dhe në përgjigjet e pyetësorëve dhe intervistat me punonjësit e drejtorive.

në zinxhirin e proceseve, por DPRMSH dhe DDRMSH-të nuk përfshihen në institucionet dhe strukturat vendore të mbrojtjes civile, si dhe strukturat e decentralizuara të institucioneve dhe strukturave qendrore të mbrojtjes civile, për ndërhyrjen e tyre në kohë reale, duke mos harruar rëndësinë e faktorit “kohë”.

2. Fusha e përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe kompetencat për realizimin e saj të parashikuara në Ligjin nr.64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e drejtimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Ligjin nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, Ligjin nr. 9990, datë 10.04.2008, i ndryshuar, VKM-në Nr. 923, datë 25.11.2020, “Për funksionimin dhe organizimin e Komitetit të Mbrojtjes Civile dhe bashkëpunimin ndërinstytucional të institucioneve dhe të strukturave të sistemit të mbrojtjes civile” dhe VKM-në Nr.1020, datë 16.12.2020 “Për përbërjen, funksionimin dhe detyrat e Komisionit Teknik Këshillimor për zvogëlimin e riskut ndaj fatkeqësive”, etj., parashikojnë angazhimin e Forcave të Armatosura (...AKMC) dhe DDRMSH si dy struktura paralele në operacionet e ciklit të menaxhimit të fatkeqësive.
3. Nga MM pretendohet se, fusha e veprimtarisë së RMSH është më e gjerë se Mbrojtja Civile, por RMSH nuk është forcë operationale (siç është Policia e Shtetit, F.A, MZSH, Urgjenca Mjekësore, Forca Vullnetare etj.,) por struktura e vetme furnizuese, kështu që në situatat e EC, mund ta humbasin përkohësisht funksionin apo kontrollin për të cilin është krijuar¹⁹. Me miratimin e Ligjit nr. 45/2019, ky fakt nuk mund të mbetet në interpretime, por duhet sanksionuar në kuadrin rregullator, për të shmangur keqinterpretimet dhe rreziqet e mundshme.

Në zbatim të Ligjit nr. 9990, datë 10.04.2008, është miratuar VKM-ja nr.1128/2008 “Për krijimin dhe administrimin e mallrave rezervë materiale shtetërore”, e parashikuar në përmbushje të qëllimit të aktivitetit parësor të rezervës, për të garantuar qytetarët. Gjithashtu, aktet e tjera ligjore dhe nënligjore mbi të cilat operon një pjesë të rëndësishme të veprimtarisë së vet MM dhe DPRMSH, aktivitetin dytësor, janë: Ligji nr.9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Ligji nr. 9874, datë 14.2.2008 “Për ankandin publik”, i ndryshuar, VKM nr. 1719, datë 17.12.2008 “Për miratimin e rregullave të ankandit publik”, i ndryshuar (ndryshuar me VKM nr.33 datë 19.1.2011, VKM nr.692, datë 18.10.2011, VKM nr.308 datë 10.4.2013”), kohë kur RMSH ka qenë nën administrimin e MPB dhe për më tepër në kushtet e ndryshimit të varësisë administrative të tyre, nuk është përmirësuar plotësisht legjislacioni që lidhet me aktivitetin dytësor të RMSH, si: mënyrën e administrimit të RMSH, përmirësimin e procedurave në administrimin e të gjitha kategorive të mjeteve motorike nga DPRMSH (ligji është për rishikim), ndryshimet në ankandin publik (VKM-ja nr. 1719/2008, referuar kreut VI, “Mungesa e konkurrencës” lidhur me hapat e përcaktimit të çmimit fillestar në rastet e përsëritjes së ankandeve²⁰), për miradministrimin e mallrave ndihmë humanitare (cituar dhe në projektligjin e rishikuar), nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve dhe rregullat për trajtimin e tyre pas heqjes nga përdorimi, (Udhëzimi nr. 03., datë 13.03.2012 “Për afatet e përdorimit, kriteret dhe kompetencat për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve në forcat e armatosura dhe rregullat për trajtimin e tyre pas heqjes nga përdorimi”) etj.

Në përmbushje të qëllimit të rezervës së shtetit të përcaktuar në nenin 3 të ligjit²¹, vështirësive në krijim të rezervës fondeve buxhetore të parashikuara ndër vite, hapësirave ligjore të parashikuara në kuadër të zhvillimeve të fundit për administrimin e rezervës, mbivendosjes së kompetencave dhe komunikimit të dobët institucional, riskut për mos ruajtje të sasive të limitit minimal për ndërhyrje në raste emergjence, si dhe praktikave më të mira evropiane, është mëse e domosdoshme dhe e nevojshme ndërhyrja në legjislacion aktual të RMSH.

¹⁹ Përgjigje pyetësori të MM

²⁰ Intervistat dhe pyetësorët

²¹ Neni 3, Ligji 1190/2008 “Rezervat materiale krijohen për të ndërhyrë, në mënyrë operative, për mbrojtjen e popullsisë, të ekonomisë dhe mbrojtjen e vendit, në situata të gjendjes së jashtëzakonshme, gjendjes së emergjencës civile, veprimeve terroriste, veprimeve ushtarake (në gjendje lufte), të cilat sjellin dëme të menjëhershme e të rënda për jetën, për shëndetin e popullatës dhe të gjësë së gjallë, për pasurinë, për trashëgiminë kulturore dhe për mjedisin. Si dhe për dhënien e ndihmave humanitare, në përputhje me normat e së drejtës ndërkombëtare.”

Urdhri i Kryeministrit nr. 63, datë 12.04.2018 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit dhe Drejtorive Rajonale në varësi të saj”, është zbatuar jashtë afateve ligjore të parashikuara²², konkretisht të 6 urdhrat e dala për miratimin e strukturës dhe organikës referuar urdhrin të sipërcituar mbajnë datën 30.09.2022. si më poshtë:

Në kundërshtim me Urdhrin e sipërpërmendur, DPRMSH dhe DRRMSH funksionojnë dhe kryejnë aktivitetin e tyre me rregulloren e miratuar me Urdhrin nr.28, datë 24.02.2014 "Për zbatimin e Rregullores së Brendshme të DPRMSH dhe drejtorive rajonale të varësisë dhe miratimin e përshkrimit të punës të DRRMSH Tiranë", të parashikuar, ndërkohë që ka ndryshuar dhe varësia administrative e tyre.

Ndryshimet e strukturave u pasuan dhe me miratimin e VKM-së nr. 274, datë 02.05.2019 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Brendshme”, të ndryshuar²³, me propozim të Ministrisë së Brendshme, ndërkohë që RMSH ishin nën varësinë administrative të MM dhe propozimi duhet të vinte prej tyre.

Në një kohë kur decentralizimi është një nga shtyllat e reformave institucionale në të gjithë vendin, fokusi i RMSH nuk ka këtë orientim, si nga funksionet e DPRMSH ashtu dhe në raport me strukturat e emergjencave në nivel qendror e rajonal, gjë e cila vështirëson aktivitetin e DPRMSH dhe drejtorive rajonale në situata emergjencash civile²⁴.

-Nga auditimi evidentohet se, në rastin e VKM nr. 808 datë 12.12.2022 “Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Mbrojtjes te Fondi Shqiptar i Zhvillimit, të pronës me emërtim “Agjencia Lundër” me vendndodhje në Lundër, Tiranë,..... për një ndryshim në Vendimin nr. 413 datë 11.07.2007 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes (Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit)”, të ndryshuar, Agjencia Lundër ka kaluar nga Ministria e Mbrojtjes tek FSHZH, për t’u përdorur për ngritjen e një kompleksi argëtimi dhe sportiv, nuk ka qartësi lidhur me procedurën e ndjekur.

Sipas relacionit bashkëlidhur vendimit dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion grupit të auditimit nga Ministria e Mbrojtjes dhe DPRMSH, citohet se ky projekt realizon prioritetet e qeverisë, ndërkohë që:

- Nuk ishte miratuar SKZHI 2023-2030 dhe objektivat strategjikë me planet kombëtare të zhvillimit të vendit;
- Nuk është kryer dëgjësë publike me komunitetin;
- Nuk janë kryer analizat mbi kosto-përfitimin dhe rëndësinë e tij krahasuar me qëllimin e RMSH.

Për periudhën objekt auditimi iniciativat ligjore të ndërmarra nga Ministria e Mbrojtjes dhe DPRMSH janë aktet ligjore dhe nënligjore të mëposhtme në pritje për miratim:

1. Projektligji për ndryshimin e Ligjit nr. 9990, datë 10.04.2008 “Për RMSH”;
2. Projektligji për ndryshimin e ligjit për trajtimin dhe administrimin e mjeteve rrugore e lundruese të Konfiskuara, si pasojë e sekuestrimit, ndalimit apo bllokimit nga policia e shtetit deri në datë 30.10.2017;
3. Projektvendimi për ndryshimin e VKM nr. 1128, datë 05.08.2008 “Për një ndryshim në listën e mallrave rezervë material shtetërore të grupit A dhe C, lidhjen nr. 1 të VKM-së Nr. 1128, datë 05.08.2008 “Për krijimin dhe administrimin e mallrave rezervë material shtetërore”, i ndryshuar;

22

²³ VKM-së Nr. 413, datë 11.07.2007 "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Brendshme (DPRSH)"²³,

²⁴ Pohuar në pyetësor dhe intervistat në fazën e terrenit

Veç akteve të sipërpërmendura, disa prej akteve të tjera mbi të cilat zhvillon aktivitetin e vet parësor dhe dytësor DPRMSH-ja, janë ende të parishikuara dhe kanë humbur efektin juridik të zbatimit të tyre, referuar dhe zhvillimeve të fundit në fushën e mbrojtjes civile, si:

- Udhëzimi i Këshillit të Ministrave Nr.1, datë 18.02.2015, “Për mënyrën e marrjes në dorëzim të mallrave nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale Shtetërore”.
- Urdhri nr. 636, datë 15.04.2011 i Ministrit të Mbrojtjes “Për miratimin e rregullores “Për procedurat e ndjekjes të çështjeve gjyqësore dhe të zbatimit të vendimeve gjyqësore në të cilat preken interesat e Ministrisë së Mbrojtjes dhe të strukturave të tjera të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.
- Udhëzimi i përbashkët nr. 556/1 Prot., datë 29.04.2011 i MB dhe Udhëzimi nr. 163/3 Prot., datë 31.03.2011 i MF “Për procedurat e marrjes në dorëzim dhe asgjësimin e produkteve të duhanit që kalojnë në administrim të DPRMSH”.
- Udhëzimi i përbashkët Nr. 1116/5 Prot., datë 29.04.2013 i MB dhe Nr. 2311/1 Prot., datë 07.05.2013 i MSH “Për procedurat e administrimit dhe asgjësimin e barnave që kalojnë në DPRMSH si pasojë e konfiskimit”, pika 4 dhe Ligji nr.10431 , datë 09.06.2011 “ Për mbrojtjen e mjedisit”.
- Udhëzimi nr. 03, datë 13.03.2012 “Për afatet e përdorimit, kriteret, procedurat dhe kompetencat për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve në forcat e armatosura dhe rregullat për trajtimin e tyre pas heqjes nga përdorimi”.

1.Gjetje nga auditimi: Ministria e Mbrojtjes, si institucion politikë bërës, nuk ka një vizion të qartë për rezervën materiale të shtetit në përgjigje të përballimit të situatave me të cilat mund të përballet vendit dhe përmbushjen e misionit të saj.

Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2023-2030, planifikuar në SKZHI 2015-2020, nuk ka një plan konkret veprimi , i cili të përfshijë rezervën materiale të shtetit.

Direktivat e Ministrisë së Mbrojtjes, nuk janë zbrëthyer në plane veprimi me objektiva të mirë përcaktuar dhe indikatorë të matshëm për rezervën materiale.

1.1 Rekomandimi: Ministria e Mbrojtjes, të bëjë pjesë të strategjive sektoriale rezervën materiale të shtetit, në kuadër të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2023-2030 dhe Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2015-2030.

Brenda vitit 2023

2.Gjetje nga auditimi: Ministria e Mbrojtjes dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit nuk kanë përmirësuar legjislacionin aktual për rezervën materiale të shtetit, referuar zhvillimeve të fundit për mbrojtjen civile.

Aktiviteti i rezervës materiale të shtetit mbështetet mbi akte rregullatorë të cilat nuk janë azhurnuar pas ndryshimeve të ndodhura lidhur me ndryshimin e përgjegjësisë nga Ministria e Brendshme të Ministrisë së Mbrojtjes.

Urdhri i Kryeministrit për strukturat e DPRMSH-së dhe DRRMSH-ve është zbatuar jashtë afateve ligjore të parashikuara dhe këto të fundit kryejnë aktivitetin e tyre mbi rregullore të parishikuara.

2.1 Rekomandimi: Ministria e Mbrojtjes, të marrë masat e nevojshme për plotësimin dhe përditësimin e kuadrit ligjor dhe rregullator me qëllim mirëfunksionimin e rezervës materiale të shtetit.

Brenda vitit 2023


Konkluzione:

1. Mungesa e vizionit të qartë për rezervën materiale të shtetit cenon garantimin e nevojave të popullsisë në situata normale dhe të emergjencave civile.
2. Kuadri ligjor dhe rregullator i pa përditësuar ndikon negativisht në ushtrimin e aktivitetit të institucioneve përgjegjëse për rezervën materiale të shtetit.

4.1.2 A janë të qarta rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve të përfshira?

Rolet dhe përgjegjësitë DPRMSH/AKMC

DPRMSH dhe AKMC janë dy institucione në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes, struktura paralele në funksion të dhënies së ndihmës së parë të popullsisë e gjësë së gjallë gjatë situatave të emergjencave, fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësi të tjera, duke vepruar në mënyrë të diferencuar me kompetencat përkatëse. AKMC vepron nëpërmjet burimeve njerëzore të cilat shërbejnë për dhënien e ndihmës së parë në situatën e ligjëruar duke vepruar si një qendër emergjence, ndërsa rezervat materiale të shtetit nëpërmjet ndërhyrjes për ofrimin e bazës materiale ushqimore dhe industriale për popullsinë e prekur nga situata e sipërcituar.



Në përkufizimin ligjor rezervat materiale të shtetit krijohen për të ndërhyrë, në mënyrë operative, për mbrojtjen e popullsisë, të ekonomisë dhe mbrojtjen e vendit, në situata të gjendjes së jashtëzakonshme, gjendjes së emergjencës civile, veprimeve terroriste, veprimeve ushtarake (në gjendje lufte), të cilat sjellin dëme të menjëhershme e të rënda për jetën, për shëndetin e popullatës dhe të gjësë së gjallë, për pasurinë, për trashëgiminë kulturore dhe për mjedisin. Rezervat materiale

të shtetit përdoren edhe për dhënien e ndihmave humanitare, në përputhje me normat e së drejtës ndërkombëtare.²⁵

Qëllimi i Ligjit Nr.45/2019, “Për mbrojtjen civile” i miratuar gjatë vitit 2019 është zvogëlimi i riskut nga fatkeqësitë dhe realizimin e mbrojtjes civile për të garantuar mbrojtjen e jetës së njerëzve, të gjësë së gjallë, të pronës, të trashëgimisë kulturore e të mjedisit, nëpërmjet forcimit të sistemit të mbrojtjes civile.²⁶ Ndër të tjera ky ligj rregullon funksionimin e sistemit të mbrojtjes civile, duke përcaktuar përgjegjësitë e institucioneve dhe të strukturave të këtij sistemi, bashkëpunimin ndërkombëtar, të drejtat dhe detyrimet e shtetasve dhe të subjekteve private, edukimin, trajnimin dhe inspektimin.²⁷

Misioni i Ligjit Nr.45/2019, “Për mbrojtjen civile” është : Mbrojtja civile synon krijimin e kushteve për një shoqëri të aftë për të zvogëluar risqet e fatkeqësive, për të parandaluar, përgatitur, përballuar fatkeqësitë dhe për t’u rimëkëmbur, nëpërmjet një sistemi të integruar dhe efikas të mbrojtjes civile në Republikën e Shqipërisë.²⁸

Neni 3, pika 10. i Ligjit Nr.45/2019, “Për mbrojtjen civile” citon:

“Fatkeqësi të tjera” janë aksidentet teknologjike, rrugore, hekurudhore, detare, ajrore, si dhe zjarret, rrëzimet e digave, aksidentet bërthamore ekologjike ose industrial dhe aksidente të tjera të shkaktuara nga veprimi njerëzor, lufta ose gjendja emergjente, përdorimi i armëve dhe mjeteve të shkatërrimit në masë, sulmet terroriste, si dhe lloje të tjera të dhunës masive.

Strukturat operacionale të mbrojtjes civile, që angazhohen në përballimin e fatkeqësive natyrore ose fatkeqësive të tjera, janë:

- a) Forcat e Armatosura;
- b) Policia e Shtetit;
- c) Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit;
- ç) Shërbimi i Urgjencës Mjekësore dhe strukturat e tjera të shërbimit shëndetësor;
- d) Shërbimi i vullnetarëve për mbrojtjen civile.

Nga sa evidentohet DPRMSH nuk bën pjesë në strukturat operacionale të mbrojtjes civile, ndërkohë që në përkufizimin ligjor për RMSH sipas Ligjit Nr.9900, datë 10.04.2008 "Për rezervat materiale të shtetit", (i ndryshuar RMSH krijohet për të ndërhyrë në mënyrë operative për mbrojtjen e popullsisë, ekonomisë dhe mbrojtjen e vendit në situatat e parashikuara.

Gjithashtu fusha e veprimit të dy institucioneve është e ngjashme dhe me bazë të gjerë.

Në raste të emergjencave civile DPRMSH ka pasur bashkëpunimin me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile (AKMC) e cila ushtron aktivitetin e saj në mbrojtjen civile të shoqërisë për parandalimin, përballimin e fatkeqësive natyrore apo situatave të emergjencës sipas Ligjit Nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile”. Referuar legjislacionit në fuqi për mbrojtjen civile edhe pse AKMC është strukturë e mirë organizuar për dhënien e ndihmës në burime njerëzore dhe logjistike për të ofruar ndihmën e parë në përballimin e një situatë emergjente apo fatkeqësie natyrore, praktika ka treguar që NJVQV përcjellin kërkesat e tyre për ndihmë me mallra tek AKMC. Këto kërkesa përcillen nga AKMC pranë DPRMSH së bashku me aktet përkatëse bashkëlidhur, mbi të cilat DPRMSH vijon me trajtimin sipas procedurës së përshkruar sa më sipër sipas Ligjit për rezervat materiale të shtetit dhe akti i miratimit të lëvrimin të mallrave të grupit C i përcillet për njohje dhe zbatim strukturës përfituese, Prefekturës përkatëse.²⁹

Nga konstatimi gjatë auditimit, konkretisht DRRMSH, janë shprehur se gjatë ushtrimit të aktivitetit të tyre, pengesë krijon qarkullimi burokratik i kërkesave për furnizim me mallra e materiale rezervë shteti, ndihmave humanitare etj., nga pushteti vendor tek Prefekti i Qarkut, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, DPRMSH-ja dhe në fund tek DRRMSH-të për ekzekutimin e tyre.³⁰

²⁵ Ligji Nr.9900, datë 10.04.2008 "Për rezervat materiale të shtetit", i ndryshuar, neni 3

²⁶ Ligji Nr.45, datë 18.07.2019, “Për Mbrojtjen Civile”, neni 1 , pika 1

²⁷ Ligji Nr.45, datë 18.07.2019, “Për Mbrojtjen Civile”, neni 1 , pika 2

²⁸ Ligji Nr.45, datë 18.07.2019, “Për Mbrojtjen Civile”, neni 32

²⁹ Përgjigje e pyetësorëve nga DPRMSH datë 15.05.2023

³⁰ Përgjigje e pyetësorëve nga DPRMSH datë 15.05.2023

Mbivendosja me Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e Konfiskuara

Në përkufizimin ligjor të Ligjit nr. 9900, datë 10.04.2008 “Për rezervat materiale të shtetit”, i ndryshuar “Mallra të konfiskuara” janë mjetet e punës, lëndët e para, materialet, karburantet, produktet e gatshme, vlerat e tjera materiale dhe të gjitha sendet, që kalojnë në pronësi të shtetit, me vendim të formës së prerë të organit kompetent, si rrjedhojë e kundërvajtjeve administrative, veprave penale apo si pasojë e parandalimit dhe goditjes së krimit të organizuar. Këto mallra administrohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Gjithashtu në përbërjen e rezervës materiale të shtetit futen edhe mallrat, që kalojnë në pronësi të shtetit nga kundërvajtjet administrative dhe kryerja e veprave penale;³¹

Në zbatim të Ligjit nr. 9900, datë 10.04.2008 “Për rezervat materiale të shtetit”, i ndryshuar, DPRMSH, administron mallra të konfiskuara dhe sekuestruara, të cilat marrin statusin mall rezervë shteti dhe administrimi i tyre është bërë në funksion të përmbushjes së detyrimit ligjor, duke i ardhur në ndihmë popullsisë në nevojë në rast fatkeqësish natyrore apo emergjenca civile të ndryshme, etj. Në rastet e parashikuara nga ligji, DPRMSH siguron të ardhura në buxhetin e shtetit nga shitja në ankand e mallrave të konfiskuara. Vlen të theksohet fakti që administrimi i mallrave të konfiskuara dhe sekuestruara, vijon të bëhet nga organet vendore të policisë, organet tatimore dhe doganore në zbatim të akteve të tjera ligjore, si:

- Kodi i Procedurës Penale
- Ligji për kundërvajtjet administrative

Sipas ligjit nr.34/2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara“, i ndryshuar, institucioni përgjegjës për administrimin dhe/ose përdorimin e pasurive të konfiskuara është Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e Konfiskuara, institucion në varësi të Ministrisë së Drejtësisë. Gjithashtu në pikën 4, të nenit 7, të ligjit nr.34/2019, të ardhurat e përfituara nga tjetërsimi i pasurive të konfiskuara shkojnë në, buxhetin e shtetit, fondin e posaçëm për parandalimin e kriminalitetit dhe llogarinë e agjencisë së lartë përmendur. Kësisoj përfshirja e konfiskimeve si një burim për krijimin e rezervave materiale të shtetit bie ndesh dhe krijon mbivendosje me Ligjin nr.34/2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara“, i ndryshuar. Si është përmendur edhe më sipër kjo mbivendosje ka qenë një nga arsytet e kthimit të projektligjit për rezervën materiale, nga Ministria e Drejtësisë.

Karakteristikat e rezervës materiale

Legjislacioni për rezervën materiale të shtetit përcakton “Nomenklatura, sasia dhe gjendja e mallrave rezervë shtetërore kanë karakter sekret.”³²

VKM Nr.1128, datë 05.08.2008 “Për krijimin dhe administrimin e mallrave rezervë materiale shtetërore”, i ndryshuar përcakton lista përbërëse e mallrave rezervë, në lloje dhe sasi, e ndarë sipas grupeve, si dhe limiti minimal për secilin artikull të jetë sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.³³

Si është kuptuar nga subjektet nën auditim ky element dhe ku gjen zbatim ai në ushtrimin e aktivitetit. Sipas argumentimit të Ministrisë së Mbrojtjes, në kuptim të këtij neni nomenklatura, sasia dhe gjendja e mallrave rezervë shtetërore nuk mund ti vihet në dispozicion kujtdo i cili bazuar në të drejtën e informimit mund të kërkojë informacion pranë DPRMSH lidhur me këto të fundit. Referuar sa më sipër, në Ligjin nr. 9900/2008 në nenin 9 të tij janë përcaktuar strukturat kundrejt së cilave DPRMSH rezervon detyrimin për të informuar, konkretisht:

“Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit vë në dijeni, periodikisht, ministrin, Këshillin e Ministrave dhe, kur i kërkohet, Komitetin Ndërmintor të Emergjencave Civile, për gjendjen e mallrave rezervë materiale të shtetit.”

³¹ Ligji nr. 9900, datë 10.04.2008 “Për rezervat materiale të shtetit”, i ndryshuar, neni 4, pika c.

³² Ligji nr. 9990, datë 10.04.2008 “Për rezervat materiale të shtetit”, i ndryshuar, neni 5, pika 4

³³ VKM Nr.1128, datë 05.08.2008 “Për krijimin dhe administrimin e mallrave rezervë materiale shtetërore”, i ndryshuar, pika 1.

Në zbatim të dispozitave të mësipërme DPRMSH ka kryer informimin periodik dhe sa herë është kërkuar pranë Ministrinë të Linjës dhe Këshillin e Ministrave, si dhe në rastet e gjendjes së jashtëzakonshme edhe KNEC.³⁴

Në argumentimi e DPRMSH të këtij elementi citohet: pavarësisht dispozitave të mësipërme vlerësojmë se është e nevojshme ndërmarrja e iniciativave më të thelluara për klasifikimin e informacionit mbi nomenklaturën, sasinë dhe gjendjen e mallrave rezervë shtetërore si informacion me karakter të klasifikuar sekret apo konfidencial në përputhje me Ligjin Nr.8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”.

në kuadër të ruajtjes së karakterit sekret të gjendjes së mallrave rezervë shtetit. Rezervat Materiale të Shtetit nuk lejojnë hyrjen e personave të huaj (publik apo privat) brenda territorit të rezervave pa u pajisur me autorizim përkatës. Në rastet kur kemi të bëjmë me verifikimin e gjendjes së mallrave që janë në procedurë shitje me ankand apo identifikimin e mjeteve për qarkullim për transferim kapital institucioneve të tjera hyrja e subjekteve të interesuara bëhet përveç autorizimit dhe me shoqërim nga një punonjës i DRRMSH përkatëse, konform të gjitha rregullave identifikuese të hyrje daljeve në territor.³⁵

Nga ana e DRRMSH-ve, kryesisht ky element gjen zbatim si më poshtë citohet: Nomenklatura e mallrave rezerve shteti ruhet në programin financiar “financa 5” e cila është e instaluar nga DPRMSH. Kompjuteri ku është instaluar financa -5 është i mbrojtur nga sistemi i Ministrisë së Mbrojtjes. Në këtë program kanë akses punonjësit e DPRMSH për të verifikuar dhe kontrolluar veprimet e kryera.

Struktura dhe organika e rezervës materiale

Ndryshimi i përgjegjësisë administrative të DPRMSH nga Ministria e Brendshme tek Ministria e Mbrojtjes u krye me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.9, datë 12.01.2018 duke u pasuar me implementimin e strukturës së re të miratuar me Urdhrit të Kryeministrit Nr.63, datë 12.04.2018 ” Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit dhe Drejtorive Rajonale”.

Në vijim të sa më sipër struktura e rezervës materiale të shtetit pati ndryshime në organikë duke sjellë numrin e punonjësve të DPRMSH gjithsej 22 dhe numrin e punonjësve të DRRMSH gjithsej 73.

Organika e DPRMSH përbëhet nga 95 punonjës prej të cilëve 40 nëpunës civilë dhe 55 punonjës mbështetës, marrëdhëniet e punës së të cilëve rregullohen me Kodin e Punës së RSH. Pas implementimit të strukturës në mars të vitit 2019 e në vijim, dinamika e lëvizjeve të personelit si lëvizje paralele, ngritje në detyrë, largim me dorëheqje, pezullim nga shërbimi civil etj., ka krijuar një numër të konsiderueshëm pozicionesh vakante. Pavarësisht raportimeve periodike nga ana e DPRMSH në organin kompetent DAP, për plotësimin e organikës situata ka vijuar të jetë e njëjtë.

Për periudhën objekt auditimi, nga evidenca lidhur me vendet vakante në strukturën e RM rezulton si më poshtë:

Për vitin 2019 11 pozicione vakante

Për vitin 2020 14 pozicione vakante

Për vitin 2021 13 pozicione vakante

Për vitin 2022 14 pozicione vakante

Mungesa e personelit ka sjellë jo vetëm problematikën e plotësimit të anëtarëve të grupeve të punës apo komisioneve për aktivitete të caktuara, por ka prodhuar edhe kosto financiare pasi shpesh është e nevojshme angazhimi i personelit nga DPRMSH apo nga një drejtori tek një drejtori tjetër varësie. Mbi të gjitha organika aktuale ka evidentuar problematika gjatë përballimit të situatave

³⁴ Përgjigje e pyetësorëve nga Ministria e Mbrojtjes datë 02.05.2023

³⁵ Përgjigje e pyetësorëve nga DPRMSH datë 15.05.2023


emergjente për përbalimin e volumit të punës, duke sjellë nevojën për punë me orare të tej zgjatura.³⁶

Tabela nr. 1 Struktura e Rezervës Materiale për periudhën 2019-2022

Emërtimi	2019			2020			2021			2022		
Institucionet	Numri total sipas strukturës	Numri i vendeve vakant	Raporti v. Vakante/total (%)	Numri total sipas strukturës	Numri i vendeve vakant	Raporti v. Vakante/total (%)	Numri total sipas strukturës	Numri i vendeve vakant	Raporti v. Vakante/total (%)	Numri total sipas strukturës	Numri i vendeve vakant	Raporti v. Vakante/total (%)
DPRMSH	22	5	23	22	5	23	22	3	14	22	3	14
DRRMSH Tiranë	37	2	5	37	3	8	37	3	8	37	3	8
DRRMSH Shkodër	10	2	20	10	3	30	10	3	30	10	3	30
DRRMSH Dibër	10	2	20	10	2	20	10	2	20	10	3	30
DRRMSH Fier	8	1	13	8	1	13	8	1	13	8	1	13
DRRMSH Korçë	8	0	0	8	0	0	8	0	0	8	1	13
Totali	95	12	13	95	14	16	95	12	13	95	14	16

Burimi i informacionit DPRMSH Përpunoi: Grupi i Auditimit

Grafiku nr. 1 Dinamika e pozicioneve vakante dhe numrit të punonjësve të organikës së RMSH




Burimi i informacionit DPRMSH, Përpunoi: Grupi i Auditimit

Grafiku nr. 2 Paraqitja grafike % numri i vendeve vakante/numrin e punonjësve total për DRRMSH Shkodër dhe Dibër.

³⁶ Përgjigje e pyetësorëve nga DPRMSH datë 15.05.2023

DRRMSH Shkoder/Diber viti 2022



Burimi i informacionit DPRMSH, Përpunoi: Grupi i Auditimit

Si shihet edhe nga paraqitja grafike numri i vendeve vakante vazhdon të jetë i lartë në raport me strukturën e miratuar, sidomos në DRRMSH Shkodër dhe Dibër ku rreth 30% e pozicioneve të miratuara sipas strukturës vijojnë të jenë të paplotësuara për gjatë gjithë periudhës 2019-2022.

DPRMSH ka kryer raportimet përkatëse pranë Njësisë Përgjegjëse Departamentit të Administratës Shtetërore (DAP), si edhe pranë Ministrisë së linjës gjatë planifikimit të pozicioneve vakante vjetore. Për një pjesë të pozicioneve të shpallura nga DAP, nuk ka pasur fitues edhe pse pozicionet janë shpallur disa herë radhazi. Sqarojmë se një pjesë tjetër e këtyre pozicioneve nuk i janë nënshtruar asnjë herë të vetme procedurave të publikimit. Për sa më sipër situata me pozicionet vakante ka vijuar të rritet duke sjellë pengesa në miradministrimin e aktivitetit ashtu dhe ngarkesës për personelin.³⁷

Aktualisht në organikën e RMSH ka katër pozicione në nivel drejtues me punonjës të komanduar, konkretisht si më poshtë:

- Pozicioni i Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit në të cilin është komanduar z. Sokol Zaimi, me detyrë Drejtor i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, sipas shkresës Nr. 439/1 prot., datë 25.02.2020 “Njoftim për ngarkim të detyrave dhe kompetencave”, të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mbrojtjes, pas vakancës së krijuar prej dorëheqjes së punonjësit që mbante këtë pozicion.
- Pozicioni i Drejtorit të Drejtorisë Rajonale të Rezervave Materiale të Shtetit Tiranë, në të cilin është komanduar z. A. L., me detyrë Përgjegjës i Sektorit Teknik, në DRRMSH Tiranë, sipas Urdhrit Nr. 219, datë 06.12.2018 “Për delegim kompetence”, të Drejtorit të Përgjithshëm të DPRMSH, pas kërkesës për pezullim të statusit nga shërbimi civil të nëpunësit që mbante këtë pozicion.
- Pozicioni i Drejtorit të Drejtorisë Rajonale të Rezervave Materiale të Shtetit Shkodër, në të cilin është emëruar përkohësisht z. Marash Kolaj, sipas Urdhrit nr. 423, datë 06.10.2020 “Për emërim në detyrë”, të Drejtorit të Përgjithshëm të DPRMSH deri në plotësimin e pozicionit vakant nga DAP sipas procedurave të Ligjit nr.152/2013“ Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.
- Pozicioni i Drejtorit të Drejtorisë Rajonale të Rezervave Materiale të Shtetit Korçë, në të cilin është emëruar z. Ornild Demollari, sipas Urdhrit nr. 198, datë 10.08.2021 “Për emërim në detyrë”, të Drejtorit të Përgjithshëm të DPRMSH deri në plotësimin e pozicionit vakant nga DAP sipas procedurave të Ligjit nr.152/2013“ Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

³⁷ Përgjigje e pyetësorëve nga DPRMSH datë 15.05.2023

Ligji nr. 9900, datë 10.04.2008 “Për rezervat materiale të shtetit”, neni 6, Organizimi dhe funksionimi, pika 7 citon: Drejtori i Përgjithshëm i DPRMSH emërohet, lirohet/shkarkohet nga detyra me urdhër të ministrit që mbulon këtë fushë të veprimtarisë.

Nga shqyrtimi i evidencës lidhur me emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit për periudhën objekt auditimi 2019-shkurt 2023, rezultoi si më poshtë:

Me Urdhër të Ministrit të Mbrojtjes nr. 54 datë 15.01.2019, për ndërprerje të marrëdhënieve financiare të nëpunësit civil, lirohet nga detyra z. I. D. në pozicionin DP DPRMSH.

Me shkresën 504/1 datë 24.01.2019, Njoftim për ngarkim detyre dhe kompetence, nisur nga vakanca, ngarkohet z. S. Z. për kryerjen e detyrave dhe kompetencave të DP DPRMSH.

Me Urdhër të Ministrit të Mbrojtjes nr. 229 datë 19.02.2019 për emërim në detyrë, z. P. L. emërohet me detyrë në pozicionin DP DPRMSH.

Me Urdhër të Ministrit të Mbrojtjes nr. 174 datë 11.02.2020. për ndërprerje të marrëdhënieve të punës, lirohet nga detyra z. Irfan Dashi në pozicionin DP DPRMSH.

Nëpërmjet shkresës Nr. 439/1 prot., datë 25.02.2020 “Njoftim për ngarkim të detyrave dhe kompetencave”, të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mbrojtjes, komandohet z. S. Z. me detyrë Drejtor i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve. Shkresa e sipërcituar në mungesë të Sekretarit të Përgjithshëm është firmosur nga Drejtori i Përgjithshëm i Politikave të Mbrojtjes z. F. K.

Me Urdhër të Kryeministrit nr.45 datë 31.03.2023, për lirimin dhe emërimin në detyrë të Kryeinspektorit të Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut, z. S. Z. emërohet Kryeinspektor i Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut.

Bazuar në dorëheqjen e paraqitur nga z. S. Z. të datës 07.04.2023, me Urdhër të Ministrit të Mbrojtjes nr. 616 datë 13.04.2023 për ndërprerjen e marrëdhënieve financiare të nëpunësit civil, lirohet nga detyra e DP DPRMSH z. S.Z.

Me Urdhër të Ministrit të Mbrojtjes nr. 691 datë 28.04.2023 Për caktim në detyrë”, për nevoja pune caktohet të kryejë detyrën Drejtor i Përgjithshëm i DPRMSH z. R. H., me detyrë Drejtor në Drejtorinë e Gatishmërisë dhe Koordinimit të Përgjigjes Civile pranë AKMC, për periudhën 02.05.2023-02.06.2023.

Nga sa më sipër, rezulton se pozicionet e disa drejtuesve të DRRMSH si edhe pozicioni i Drejtorit të Përgjithshëm të DPRMSH ka qenë i paplotësuar konform kuadrit ligjor të përcaktuar, çka riskon mirë menaxhimin e aktivitetit të rezervës materiale të shtetit.

Gjithashtu një ndër problematikat e raportuara nga subjektet nën auditim, pas ndryshimeve e organikës nëpërmjet Urdhrit të Kryeministrit Nr.63, datë 12.04.2018 ” Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit dhe Drejtorive Rajonale”, është dhe ndryshimi i emërtimeve të drejtorive rajonale që ka sjellë konfuzion në raport më marrëdhëniet dhe korrespondencën me publikun dhe me institucionet e tjera, kjo për shkak se emërtesa e drejtorisë në shumicën e rasteve e rasteve nuk ka vendndodhje të njëjtë sipas emërtesës.


DRRMSH Shkodër me zyra qendrore të aktivitetit në Pukë

DRRMSH Dibër me zyra qendrore të aktivitetit në Burrel

DRRMSH Fier me zyra qendrore të aktivitetit në Vlorë

Gjatë auditimit është evidentuar se asetet që kanë në përgjegjësi 5 DRRMSH kanë shtrirje të gjerë në territor. Një pjesë e madhe e tyre janë jashtë kontrollit të këtyre institucioneve dhe përbëjnë risk të lartë për përdorim nga aktivitete të jashtëligjshme. Nga intervistimet e drejtuesve të gjithë institucioneve rezulton se kontrolli i këtyre objekteve kryhet nëpërmjet inspektimeve të cilat për shkak të pamundësive edhe financiare nuk kanë vijimësi dhe në disa raste monitorimi i tyre kryhet në marrëveshje me banorë të zonave përreth.

Figura nr. 1 Harta e mbulimit administrativ të DRRMSH



Burimi i informacionit DPRMSH

Ndryshimet e strukturës paraqesin një numër të lartë të pozicionit roje në organikat e DRRMSH, të cilët edhe pse mesatarisht zënë rreth 50% të numrit të punonjësve në total, nuk përmbushin nevojat e institucioneve për ruajtjen e objekteve për shkak të shtrirjes së gjerë të aseteve në territor.

Tabela nr. 2 Raporti (%) Pozicioni roje/ Totalit të punonjësve sipas strukturës së DPRMSH

Emërtimi	Numri total sipas strukturës	Pozicioni Roje	Raporti Roje/total (%)
DRRMSH Tiranë	37	22	59
DRRMSH Shkodër	10	4	40
DRRMSH Dibër	10	5	50
DRRMSH Fier	8	3	38
DRRMSH Korçë	8	4	50

Burimi i informacionit: DPRMSH

Përpunoi: Grupi i Auditimit

Sipas raportimeve nga subjektet rezultojnë se bazuar në analizat e kryera mbi strukturën e implementuar janë evidentuar kryesisht problematika në organizimin e burimeve njerëzore, eficiencës në punë dhe menaxhimin e mallrave të magazinuara sidomos në DRRMSH Tiranë duke qenë se aktualisht 2 magazinier (një në Lundër dhe një në Shkozë) mbajnë përgjegjësi për 8 magazina me shpërndarje në Tiranë, Durrës dhe Elbasan (Shushicë).

Theksojmë se DRRMSH Tiranë është drejtoria rajonale kryesore për administrimin e mallrave ushqimore dhe industriale. Përqendrimi i aktivitetit të kësaj drejtorie në Agjencinë Lundër, për shkak të infrastrukturës së konsoliduar të kësaj agjencie për magazinimin e mallrave, si dhe vendosjes së administratës e ka bërë të vështirë administrimin e mallrave.

Shkrirja e DRRMSH Durrës duke suprimuar vendet me status të nëpunësit civil ka influencuar negativisht në raportet institucionale që kjo drejtori shumë e rëndësishme, nga pikëpamja strategjike, ka pasur me institucione si Dogana, Tatimet, Përmbartimi etj., duke sjellë një ulje të ndjeshme të sasisë së mallrave të marrë në dorëzim.³⁸

³⁸ Përgjigje pyetësorët e fazës së terrenit DRRMSH Tiranë dt. 15.05.2023

Në vijim të Urdhrit të Ministrit nr. 1615 datë 21.09.2022 “Për ngritjen dhe funksionimin e grupit të punës për rishikimin e strukturave të institucioneve të varësisë së Ministrisë së Mbrojtjes” dhe shkresës nr. 4815/1 datë 26.09.2022 “Dërgim propozime për rishikime strukturore”, e cila citon : Propozimet të shoqërohen me argumentet përkatëse si dhe kostot e përafërta financiare. Të mbahet në konsideratë që ndryshimet të mos sjellin shtesa në numrin e personelit.

Nga ana e DPRMSH në përgjigje të shkresës së sipërcituar është përgatitur relacioni dhe projekt struktura për miratimin e ndryshimit të strukturës dhe organikës së DPRMSH dhe DRRMSH në varësi të saj, informacion i përcjellë me shkresën 1238/1 datë 06.10.2023.

Në relacionin shoqëruar argumentohet nevoja e ndryshimeve në strukturë duke mbajtur të pandryshuar numrin e personelit, sipas kërkesës së parashtruar nga Ministria e Mbrojtjes.

Ndryshimet e propozuara nga ana e DPRMSH nuk përmbajnë në thelb përmirësimin e performancës së rezervës materiale, ato suprimojnë pozicione specialistësh nga drejtoritë rajonale në përmbushje të nevojave të strukturës qendrore.

Aktualisht propozimi i kryer nga DPRMSH si për ndryshimin e strukturës ashtu edhe ndryshimet lidhur me emërtimet e propozuara për DRRMSH, nuk ka pasur përgjigje nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes.

Gjatë auditimit u konstatua se të gjitha adresat elektronike të Drejtorisë së Përgjithshme dhe drejtorive rajonale, funksiononin me adresa personale dhe nuk dispononin adresa brenda rrjetit *e-gov*. Ndërkohë që shërbimi i ofrimit të postës elektronike nga Institucionet dhe organet e Administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave, duhet të kryhet nëpërmjet rrjetit GOV NET.

1.Gjetje nga auditimi: Baza ligjore aktuale në përballimin e situatave emergjente nuk garanton qartësinë dhe detyrimet respektive të roleve, përgjegjësi dhe kompetencave të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervës Materiale të Shtetit, Agjencisë Kombëtare të Emergjencave Civile dhe institucioneve të tjera të cilat janë të përfshira në përballimin e situatave emergjente. Ligji Nr.9900, datë 10.04.2008 "Për rezervat materiale të shtetit", i ndryshuar dhe Ligji Nr.45, datë 18.07.2019, “Për Mbrojtjen Civile”, krijojnë paqartësi të roleve dhe mbivendosje kompetencash. Nuk evidentohet përgjegjësia dhe mënyra e bashkëpunimit dhe koordinimit mes dy institucioneve të përfshira, të cilat veprojnë veçmas referuar kuadrit ligjor aktual, në përballimin e situatave të parashikuara.

1.1 Rekomandimi: Ministria e Mbrojtjes, nëpërmjet një grupi pune, të kryejë vlerësimin e roleve dhe përgjegjësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervës Materiale të Shtetit dhe Agjencisë Kombëtare të Emergjencave Civile për qartësimin dhe harmonizimin e kuadrit ligjor të këtyre institucioneve.

Brenda vitit 2023

2. Gjetje nga auditimi: Ligji nr. 9900, datë 10.04.2008 “Për rezervat materiale të shtetit”, i ndryshuar, ka mbivendosje me Ligjin nr.34/2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara”, i ndryshuar lidhur me administrimin e mallrave të sekuestruara dhe konfiskuara. Nga auditimi rezultoi se, vendimet gjyqësore të marra lidhur me pasuritë/mallrat e konfiskuara ose sekuestruara si rezultat i kryerjes së veprave penale në disa raste adresohen pranë Rezervës Materiale të Shtetit dhe në raste të tjera pranë Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara, ndërkohë që ky i fundit është institucioni i posaçëm për këtë qëllim.

2.1 Rekomandimi: Ministria e Mbrojtjes ti drejtohet Këshillit të Lartë Gjyqësor për të unifikuar praktikën e vendimeve gjyqësore për konfiskimet dhe sekuestrimet e pasurive dhe mallrave që vijnë si rezultat i veprave penale drejt institucionit të posaçëm të krijuar për këtë qëllim.

3. Gjetje nga auditimi: VKM nr.1128, datë 05.08.2008 “Për krijimin dhe administrimin e mallrave rezervë materiale shtetërore”, i ndryshuar, përcakton se lista përbërëse e mallrave rezervë, në lloje dhe sasi, e ndarë sipas grupeve, si dhe kufiri minimal për secilin artikull të jetë sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.³⁹ Lista me nomenklaturën e mallrave rezervë shteti e cila përmban gjendjen orientuese të tyre si dhe sasinë limit i detyrueshëm, është e publikuar, duke mos garantuar në këtë mënyrë ruajtjen e karakterit sekret sipas përcaktimit ligjor.

3.1 Rekomandimi: Ministria e Mbrojtjes në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervës Materiale të Shtetit, të kryejë analizë dhe vlerësim të karakterit sekret të nomenklaturës, gjendjes dhe sasive të rezervës materiale të shtetit me qëllim qartësimin e mënyrës së funksionimit të proceseve në ruajtjen e këtij karakteri apo dhe ndërmarrjen e nismave të nevojshme ligjore për rregullimin e tij.

Brenda vitit 2023

4. Gjetje nga auditimi: Struktura aktuale e rezervës materiale të shtetit është jo e plotë dhe e pamjaftueshme për të përmbushur qëllimin për të cilin është krijuar. Organika e miratuar nëpërmjet Urdhrit të Kryeministrit Nr.63, datë 12.04.2018 ” Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit dhe Drejtorive Rajonale”, pasoi me dinamikë e lëvizjeve të personelit si lëvizje paralele, ngritje në detyrë, largim me dorëheqje, pezullim nga shërbimi civil etj., ka krijuar një numër të konsiderueshëm pozicionesh vakante, gjithsej 14 punonjës.

4.1 Rekomandimi: Ministria e Mbrojtjes në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit, të kryejë analizë dhe vlerësim të strukturës aktuale të rezervës materiale, si në nivel qendror ashtu edhe rajonal referuar qasjes institucionale që rezerva materiale e shtetit do të ketë.

Brenda vitit 2023

5. Gjetje nga auditimi: Emërtimet e Drejtorive Rajonale të Rezervës Materiale të Shtetit, Shkodër, Dibër, Fier, nuk përkojnë me vendndodhjen e tyre në fakt, duke sjellë për pasojë konfuzion gjatë ushtrimit të aktivitetit.

5.1 Rekomandimi: Ministria e Mbrojtjes të ndërmarrë veprimet e nevojshme për ndryshimin e emërtimeve të drejtorive rajonale, të cilat nuk përkrijnë me vendndodhjen e tyre reale.

Brenda vitit 2023

6. Gjetje nga auditimi: Në Rezervat Materiale të Shtetit konstatohet një numër i lartë drejtuesish me funksione të komanduara në tejkalim të afateve të përcaktuara⁴⁰.

- Pozicioni i Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit gjendet i komanduar prej disa vitesh, ndërsa shkresa për ngarkim të detyrave nuk është në përputhje me kuadrin ligjor.⁴¹
- Pozicioni i Drejtorit të Drejtorisë Rajonale të Rezervës Materiale të Shtetit Tiranë, është i komanduar prej disa vitesh;
- Ndërkohë pozicionet e Drejtorit të Drejtorisë Rajonale të Rezervave Materiale të Shtetit Shkodër dhe Korçë janë emërimet të përkohshme, respektivisht prej vitit 2020 dhe vitit 2021.

6.1 Rekomandimi Ministria e Mbrojtjes të marrë masa të menjëhershme për plotësimin e pozicionit të Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të

³⁹ VKM Nr.1128, datë 05.08.2008 “Për krijimin dhe administrimin e mallrave rezervë materiale shtetërore”, i ndryshuar, pika 1.

⁴⁰ Vendim nr. 125, datë 17.2.2016 “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”, Kreu 1, pika 2 a.

⁴¹ Ligji nr. 9990, datë 10.04.2008 "Për rezervat materiale të shtetit", i ndryshuar, neni 6, pika 7

Shtetit si edhe drejtorëve rajonalë, të cilët rezultojnë të komanduar ose me emërim të përkohshëm, në tejkallim të afateve të përcaktuara.

Brenda vitit 2023

7. Gjetje nga auditimi: Struktura e Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervës Materiale të Shtetit dhe drejtorive rajonale prej një kohe të gjatë paraqitet me disa pozicione vakante. Propozimet e kryera nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervës Materiale të Shtetit për ndryshimin e strukturës aktuale nuk kanë qenë tërësisht në funksion të rritjes së efektivitetit të rezervës materiale të shtetit dhe performancës së institucionit. Ministria e Mbrojtjes nuk ka marrë në konsideratë propozimet e kryera për ndryshimin e strukturës së rezervës materiale të shtetit.

Brenda vitit 2023

7.1 Rekomandimi: Ministria e Mbrojtjes në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit, të marrë masa për plotësimin e vendeve vakante në të gjitha nivelet.

Brenda vitit 2023

8. Gjetje nga auditimi: Sistemi i komunikimeve elektronike zyrtare i Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit dhe drejtorive rajonale, funksionon nëpërmjet adresave personale dhe jo brenda rrjetit Gov-Net.

8.1 Rekomandimi: Ministria e Mbrojtjes të ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm ligjorë për përfshirjen e Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave të Shtetit dhe njërive të varësisë brenda rrjetit Gov-Net, me qëllim garantimin e sigurisë në komunikimet elektronike.

Brenda vitit 2023

Konkluzione:

1. Mungesa e përcaktimit qartë e rolit të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervës Materiale të Shtetit, Agjencisë Kombëtare të Emergjencave Civile dhe institucioneve të tjera të cilat janë të përfshira, në procesin e ndërhyrjes së menjëhershme për përballimin e situatave emergjente bart riskun e një procesi kaotik i cili shton burokracinë e veprimeve duke shkaktuar vonesa në përgjigjen ndaj qytetarit.

2. Kalimi i mallrave të konfiskuar dhe sekuestruar si rezultat i veprave penale nëpërmjet vendimeve në rezervën materiale të shtetit, ngarkon aktivitetin primar të rezervës materiale të shtetit, e cila ka një kapacitet të kufizuar të burimeve njerëzore dhe ul efektivitetin e veprimtarisë.

3. Ruajtja e karakterit sekret të nomenklaturës, sasisë dhe gjendjes së mallrave rezervë materiale e shtetit, ka ndikim të drejtpërdrejtë në forcimin e sigurisë kombëtare dhe besimin e qytetarëve.

4. Struktura jo e plotë dhe e pamjaftueshme e rezervës materiale të shtetit, vendet vakante konstante përgjithësisht përgjatë periudhës 2019 e në vazhdim, cenojnë efektivitetin e aktivitetit dhe misionit të rezervës materiale të shtetit. Pozicionet e drejtuesve të drejtorive rajonale me emërim të përkohshëm ose të komanduar, ndryshimet e shpeshta dhe pozicioni i Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit për periudhën 2019 e në vazhdim i komanduar, bartin risk të lartë për menaxhimin e rezervës materiale të shtetit.

4.2 A ka qenë efektiv mekanizmi i ngritur në funksion të rezervës materiale të shtetit ?

4.2.1 A i ka shërbyer mekanizmi i ngritur miradministrimit të rezervës materiale të shtetit ?

Krijimi dhe administrimi i rezervës materiale të shtetit rregullohet me Ligjin Nr. 9900, datë 10.04.2008 “Për rezervat materiale të shtetit”, i ndryshuar, VKM nr.1128 datë 05.08.2008 “Për krijimin dhe administrimin e mallrave rezervë materiale shtetërore”, e ndryshuar dhe Udhëzimin Nr.1, datë 18.02.2015 të Këshillit të Ministrave “Për mënyrën e marrjes në dorëzim të mallrave nga DPRMSH”.

Mallrat rezervë ndahen në mallra të grupit A, të grupit B dhe të grupit C⁴².

Lëvrimi dhe shitja e mallrave rezervë të grupit A bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit.

Lëvrimi i mallrave rezervë të grupit B bëhet me urdhër të ministrit, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Rezervave Materiale të Shtetit, në rastet e parashikuara.

Mallrat rezervë të grupit C lëvrohen me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Rezervave Materiale të Shtetit.⁴³

Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit plotëson dhe siguron sasi të dhe nomenklaturën e mallrave rezervë shtetërore, nëpërmjet:

- a) financimeve nga Buxheti i Shtetit;
- b) mallrave, që kalojnë në pronësi të shtetit nga kundërvajtjet administrative dhe veprat penale;
- c) të ardhurave dhe fondeve financiare, që realizon gjatë veprimtarisë të saj;
- ç) donacioneve dhe ndihmave të papërdorura, të cilat plotësojnë sasi të dhe nomenklaturën e parashikuar ose e shtojnë atë.⁴⁴

Lista përbërëse e mallrave rezervë, në lloje dhe sasi, e ndarë sipas grupeve, pjesë përbërëse e VKM-së përcakton gjendjen orientuese dhe sasinë limit të detyrueshme për secilin artikull.

DPRMSH me anë të urdhrave të strukturës kompetente për secilën kategori grup mallrash dhe parashikimeve ligjore, duhet të kryejë lëvrimin e tyre rast pas rasti duke marrë në konsideratë gjithmonë ruajtjen e limitit minimal të sasive të përcaktuara në VKM nr.1128 datë 05.08.2008 "Për krijimin dhe administrimin e mallrave rezervë materiale shtetërore", e ndryshuar.

VKM-ja e sipërcituar është rishikuar dy herë, përkatësisht me:

- VKM-në nr. 481, datë 25.06.2016⁴⁵, sipas të cilit mallrat që nuk financohen nga buxheti i shtetit në çdo kohë transferohen pa pagesë nga DPRMSH te subjektet shtetërore ose u shiten subjekteve private, sipas miratimit të organit, që ka këtë kompetencë.
- VKM-në nr.870, datë 11.11.2020,⁴⁶ duke shtuar ushqimin koncentrat për kafshët në listën përbërëse të mallrave rezervë shteti, të grupit C.

Ndryshimet e sipërpërmendura nuk prekën thelbin e VKM-së⁴⁷, edhe pse, gjatë periudhës 2019-2022, vendi ynë pësoi goditje të njëpasnjëshme, si: tërmeti i fuqishëm në fund të vitit 2019, pandemia globale e COVID-19 në fillim të vitit 2020, etj.

Ndryshimet në nomenklaturën e mallrave rezervë shteti, janë kryer mbi një kuadër rregullator të parishikuar për mbrojtjen civile⁴⁸ dhe pa një metodologji të përcaktuar, referuar rëndësisë, burimeve të financimit, ndryshimit të numrit të popullsisë, ndryshimeve demografike, etj. DPRMSH nuk ka kryer një analizë të detajuar bazuar në nevojat e identifikuar, faktorët social-ekonomikë, etj., mbi bazën e të cilave bëhet parashikimi i kriterëve normative, sasisë dhe llojit të mallrave rezervë materiale e shtetit. Gjendja orientuese e sasisë së mallrave rezervë shteti dhe limiti minimal parashikohen sipas nevojave për blerje në bazë të fondeve buxhetore vjetore që akordohen për këtë qëllim, rast pas rasti sipas urdhrave përkatëse për lëvrimin e tyre. Aktualisht mallrat ushqimorë pjesë e rezervës materiale janë të qendëruara në DRRMSH-Tiranë, me vendndodhje Lundër, e cila është edhe struktura më e rëndësishme e sa i takon aktivitetit të rezervës materiale në tërësi.

⁴² Ligjin Nr.9900, datë 10.04.2008 "Për rezervat materiale të shtetit", i ndryshuar, neni 5 pika 2

⁴³ Ligjin Nr.9900, datë 10.04.2008 "Për rezervat materiale të shtetit", i ndryshuar, neni 10

⁴⁴ VKM nr.1128 datw 05.08.2008 "Për krijimin dhe administrimin e mallrave rezervë materiale shtetërore", e ndryshuar, pika 2

⁴⁵VKM Nr. 481, datë 25.06.2016 "Për një ndryshim në Vendimin nr. 1128, datë 5.08.2008 të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin dhe administrimin e mallrave rezervë materiale shtetërore",

⁴⁶ VKM Nr.870, datë 11.11.2020 të Këshillit të Ministrave "Për një ndryshim në Vendimin Nr.1128, datë 05.08.2008 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin dhe administrimin e mallrave rezerve shtetërore".

⁴⁷ Përgjigje e pyetësorëve të DPRMSH në tabelën nr. 1

⁴⁸ Udhëzimi i Këshillit të Ministrave Nr.1, datë 18.02.2015 "Për mënyrën e marrjes në dorëzim të mallrave nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale Shtetërore".

Udhëzimi nr. 03, datë 13.03.2012 "Për afatet e përdorimit, kriteret, procedurat dhe kompetencat për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve në forcat e armatosura dhe rregullat për trajtimin e tyre pas heqjes nga përdorimi".

Drejtoritë rajonale disponojnë vetëm mallrat industrialë pjesë e rezervës materiale dhe mallra në ruajtje, për llogari të institucioneve të tjera.

Referuar VKM nr.1128 datë 05.08.2008 “Për krijimin dhe administrimin e mallrave rezervë materiale shtetërore”, e ndryshuar, lista e mallrave rezervë materiale shteti, sipas grupeve e ndarë në lloje dhe sasi, paraqitet si më poshtë:

Tabela nr. 3 Lista e mallrave rezervë materiale shteti, sipas grupeve e ndarë në lloje dhe sasi.

GRUPI A

Nr.	Artikuj	Njësia matëse	Gjendja orientuese e mallrave (sasia)	Limiti minimal	Sasia e përgjithshme e mallrave gjendje me	Sasia e përgjithshme e mallrave gjendje me dt.31.12.2020	Sasia e përgjithshme e mallrave gjendje me dt.31.12.2021	Sasia e përgjithshme e mallrave gjendje me dt.31.12.2022
1	Prodhime ari, argjendi, platini etj te kësaj natyre	kg	Relative sipas burimit	Relativ	0	0.0936 Ar	0.0936 Ar	0.0936 Ar
					0	0.80058 Argjend	0.80058 Argjend	0.80058Argjend
					0.256	0.256 Platin	0.256 Platin	0.256 Platin
2	Mjete të rënda për çdo lloj transporti	copë	50	30	10	10	10	10
3	Grurë	ton	600	300	0	0	0	0
4	Mallra të ndryshëm tepër vëllimore	Copë	Relative sipas burimit	relativ	0	0	0	0

Burimi: DPRMSH përpunuar nga Grupi i auditimit

GRUPI B

Nr.	Artikuj	Njësia matëse	Gjendja orientuese e mallrave (sasia)	Limiti minimal	Sasia e përgjithshme e mallrave gjendje me dt.31.12.2019	Sasia e përgjithshme e mallrave gjendje me dt.31.12.2020	Sasia e përgjithshme e mallrave gjendje me dt.31.12.2021	Sasia e përgjithshme e mallrave gjendje me dt.31.12.2022
1	Mjete të vogla lundrimi	copë	30	20	0	0	0	0
2	Automjete të tonazhit të ulët nën 10 ton	copë	100	80	15	18	21	26
3	Karburante	litra	200,000	100,000	0	0	0	0

Burimi: DPRMSH përpunuar nga Grupi i auditimit

GRUPI C

Nr.	Artikuj	Njësia matëse	Gjendja orientuese e mallrave (sasia)	Limiti minimal	Sasia e përgjithshme e	Sasia e përgjithshme e	Sasia e përgjithshme e mallrave gjendje me dt.31.12.2021	Sasia e përgjithshme e mallrave gjendje me dt.31.12.2022	Diferenca nga limiti Minimal 2019	Diferenca nga limiti Minimal 2020	Diferenca nga limiti Minimal 2021	Diferenca nga limiti Minimal 2022
1	Çadra strehimi	copë	700	500	1976	1530	1476	1469	1476	1030	976	969
2	Mjedise të përkohshme (rulotë kontejnerë)	copë	100	50	0	0	0	0	-50	-50	-50	-50
3	Batanije	copë	8,000	5000	5981	31525	33247	26608	981	26525	28247	21608
4	Krevat portativ me dyshekë	copë	5,000	3000	646	2941	2231/2603	1874/2267	-2354	-59	-769	-1126/767
5	Çarçafë dhe Këllëf jastëku	copë	8,000	5000	342	3100	1038/2639	254/2315	-4658	-1900	-3962	-4746/-2685
6	Jastëk	copë	8,000	3000	2161	2019	1842	1302	-2839	-981	-1158	-1698
7	Set kuzhine	copë	5,000	1000	115	98	65	61	-885	-902	-935	-939
8	Pajisje elektroshtëpiake	copë	1,000	500	658	641	371	234	158	141	-129	-266
9	Çizme gome	copë	10,000	8000	1068	837	577	397	-6932	-7163	-7423	-7603
10	Vaj ushqimor	Ton	50	30	9.5	15.7	46.3	9.8	-20.5	-14.3	16.3	-20.2
11	Sheqer	Ton	80	40	13.7	7.9	34	21.4	-26.3	-32.1	-6	-18.6
12	Oriz	Ton	80	40	13.2	7.8	37.8	21.2	-26.8	-32.2	-2.2	-18.8
13	Makarona	Ton	70	30	18.8	23.9	35.6	20.7	-11.2	-6.1	5.6	-9.3
14	Kripë	Ton	5	2	2	8.2	14.5	0.8	0	6.2	12.5	-1.2
15	Miell	Ton	400	200	24	70	2.3	1.5	-176	-130	-197.7	-198.5
16	Konserva mishi	Ton	20	10	0.1	2.6	15.1	9.9	-9.9	-7.4	5.1	-0.1
17	Fasule	Ton	50	30	2	1.6	25.2	8.8	-28	-28.4	-4.8	-21.2
18	Ujë mineral natyral	litra	5000	3000	0	32761	0	6180	-3000	29761	-30000	3180

19	Ushqim i koncentruar për kafshët	Ton	120	60	0	0	0	57.3	-60	-60	-60	-2.7
20	Ushqim voluminoz (bar i thatë)	Ton	180	90	0	0	0	0	-90	-90	-90	-90
21	Sapun	copë	30,000	15000	42868	36097	15537	1212	27868	21097	537	-13788
22	Detergjent	Ton	30	10	3.2	7.3	12.1	2.5	-6.8	-2.7	2.1	-7.5

Burimi: DPRMSH përpunuar nga Grupi i auditimit

Nga të dhënat e paraqitura më sipër rezulton se gjendja dhe limiti minimal për mallrat rezervë materiale sipas grupeve ndarë në lloje dhe sasi, për periudhën 2019-2022, vijon si më poshtë:

Grupi A

Artikulli “Mjete të rënda për çdo lloj transporti” gjendja është nën limitin minimal të përcaktuar.

Artikulli “grurë” gjendja është zero.

Grupi B

Artikulli “Mjete të vogla lundrimi” gjendja është zero.

Artikulli “Automjete të tonazhit të ulët nën 10 ton” gjendja është nën limitin minimal të përcaktuar.

Artikulli “Karburante”, gjendja është zero.

Grupi C

Gjatë periudhës së auditimit deri në fund të vitit 2022, nga 22 artikuj, 20 prej tyre janë me diferenca, mungesa jo vetëm të gjendja orientuese e mallrave (sasia) por edhe nën vlerat e limiteve minimale të përcaktuara në VKM nr.1128 datë 05.08.2008 “Për krijimin dhe administrimin e mallrave rezervë materiale shtetërore”, e ndryshuar.

Për artikujt e Grupit C, vërehet se:

- ✓ Gjendja orientuese e mallrave dhe limiti minimal është mbajtur në të njëjtat kritere (normativa), që prej vitit 2008;
- ✓ Diferencat nga limiti minimal për një pjesë të konsiderueshme mallrash janë të ndjeshme;

Pasuritë e paluajtshme të rezervës materiale të shtetit

Rezerva Materiale e Shtetit disponon aktualisht 52 astete të paluajtshme (tokë/ndërtim) në nivel kombëtar të cilat trashëgohen prej ish sistemit diktatorial. Thuajse të gjitha pronat janë të pozicionuara në vende me një rëndësi strategjike për kohën. Këto asete janë nën përgjegjësi administrimi të drejtorive rajonale të cilat disponojnë secila një numër të konsiderueshëm të tyre. Ato përbëhen nga troje dhe ndërtime të cilat pas vitit 1991 kanë pësuar transformime nga dëmtimet, mungesa e investimeve për mirëmbajtje, ndërtimet pa leje brenda tyre, etj. Me VKM nr. 413 datë 11.07.2007, është miratuar lista e pronave të cilat kaluan fillimisht në përgjegjësi materiale Ministrisë së Brendshme (për DPRMSH). Ky vendim ka pësuar ndryshime në 5 raste nga transferimet e pronave drejt institucioneve të tjera dhe në një rast është bërë ndryshimi i përgjegjësisë së administrimit të tyre në Ministrinë e Mbrotjtjes (për DPRMSH). Më poshtë paraqitet në mënyrë të përmbledhur shpërndarja e këtyre aseteve kombëtare në territor.

Tabela nr. 4 Përmbledhëse e pasurive të paluajtshme të administruara

PRONA TE ADMINISTRUARA NGA REZERVAT MATERIALE TE SHTESTIT							
Drejtoria Rajonale	Nr. Pasurish	Sipërfaqja e Përgjithshme		E regjistruar		E paregjistruar	
		Sip. truall (m ²)	Sip. ndërtese (m ²)	Sip. truall (m ²)	Sip. ndërtese (m ²)	Sip. truall (m ²)	Sip. ndërtese (m ²)
DRRMSH Tiranë	26	785,502 ⁴⁹	95,029	206,811	53,812	578,691	41,217
DRRMSH Korçë	7	380,043	28,171	68,230	14,100	311,813	14,071
DRRMSH Fier	6	183,275	22,742	183,231	22,725	44	17
DRRMSH Shkodër	6	113,957	11,725	82,792	9,371	31,165	2,353
DRRMSH Dibër	7	70,310	17,991	58,333	16,660	11,977	1,331
Totali	52	1,533,086	175,658	599,396	116,669	933,690	58,989

⁴⁹ Në këtë sipërfaqe përfshihen edhe pronat e ndodhura në Labinot dhe në Lundër pjesë e DRRMSH Tiranë.

Burimi: DPRMSH, përpunuar nga grupi i auditimit

Sa vërehet edhe më sipër, 27 prona nuk rezultojnë të regjistruara ende pranë zyrave të ASHK. Gjenden të regjistruara 25 prona që përbëjnë rreth 40% të sipërfaqes totale të truallit dhe 65% e sipërfaqes totale të ndërtesave. Pjesa më e madhe e pronave të paregjistruara në numër dhe sipërfaqe paraqitet në Drejtorinë Rajonale Tiranë e cila rezulton me 18 të tilla, më tej ajo Korçë me 4 prona, Dibër me 3 prona dhe Shkodër dhe Fier me 1 pronë të paregjistruar secila. Pavarësisht detyrave të lëna nga Ministria e Mbrojtjes për DPRMSH dhe kërkesave të vazhdueshme, situata e pronësisë vijon të mbetet problematike. Nga vizitat në terren në disa asete arritëm të evidentojmë se disa nga këto prona të paregjistruara kanë pozicionim mjaft të favorshëm dhe sipërfaqe të konsiderueshme, të cilat kanë risk të lartë për tjetërsim. Këtu mund të përmendim asetet në Rrenc/Shkodër, Milot/Dibër, etj. Nga ana e drejtorive rajonale ruhen në mënyrë të vazhdueshme vetëm një pjesë e vogël e këtyre aseteve, kryesisht në ambientet ku zhvillohet aktiviteti, pjesa tjetër inspektohet prej tyre për evidentim problematikash në frekuenca 2-javore, mujore apo dhe më gjatë. Mungesa e mbrojtjes dhe përkujdesjes së vazhdueshme të tyre ka bërë që këto asete, kryesisht ndërtesat të shkojnë drejt degradimit total.

Pronat nën përgjegjësi administrimi të rezervës materiale të shtetit kanë qenë në periudha të ndryshme edhe objekt i shitjeve apo qiradhënies. Sipas të dhënave të disponuara situata paraqitet:

- *Janë shitur* në Labinot, Elbasan pronë prej 105,127 m² truall dhe 25,532 m² ndërtim. Është privatizuar shitur gjithashtu Agjencia Qendër, Bashkia Vlorë.
- *Janë dhënë me qira* me çmimin simbolik **1 Euro dhe afat 20 vite** nga ish Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dy prona, në vitet 2014 dhe 2015 përkatësisht:
 - Asete në Dorëz, Librazhd, me sipërfaqe të përgjithshme 38,200 m², prej nga sipërfaqe nën ndërtesë 7,212 m² dhe sipërfaqe funksionale 30,988 m².
 - Asete në Plasë, Korçë një sipërfaqe e përgjithshme 8,699 m², nga të cilat, sipërfaqe nën objekt 2,200.92 m² (3 depo, kabinë, peshore) dhe sipërfaqe funksionale 6,498.08 m².
- *Janë dhënë me qira* me afat **1 vjeçar** nga DPRMSH në fund të vitit 2022, subjekteve tregtarë 2 prona me sipërfaqe 200 m² ndërtim secila përkatësisht:
 - Fushë Peshtan Berat me qëllim magazinimin e materialeve të ndërtimit, pllakave të gurit dekorativ të cilat janë pjesë objektit të veprimtarisë së subjektit si dhe
 - Dukaj, Tepelenë me qëllim magazinimin dhe ruajtjen e bazës ushqimore për bagëti të imta.
- *Është transferuar* pranë ATP për tu përdorur si fond kompensimi fizik 1 pronë në Rrëshen (NFK).
- *Janë transferuar* nën përgjegjësi administrimi institucioneve të tjera 5 prona të rezervës materiale referuar ndryshimeve në VKM nr. 413 datë 11.07.2007, e ndryshuar. Prona e fundit të cilës i është ndryshuar përgjegjësia e administrimit ndodhet në Lundër, Tiranë.

Ndryshimi i përgjegjësisë së administrimit të pronës në Lundër, Tiranë në favor të FSHZH

Në vijim të ndryshimeve të ndodhura me asetet e rezervës materiale së fundi një nga asetet e rëndësishme në vend, përkatësisht për ambientet në Lundër, Tiranë së bashku me territorin përkatës është vendosur të kalojnë nën përgjegjësi administrimi të Fondit Shqiptar të Zhvillimit, për ngritjen e një kompleksi argëtimi dhe sportiv. Kompleksi i magazinimit në Lundër shërben si pika qendrore për magazinimin e mallrave ushqimore të rezervës prej nga nis shpërndarja e tyre për drejtoritë rajonale. Në këtë kuadër ajo zë një vend kryesor në aktivitetin e rezervës materiale të shtetit. Prona rezulton me një sipërfaqe prej 95,320 m² truall dhe ndodhet në një pozicion mjaft të favorshëm për veprimtarinë. Ajo ndodhet shumë pranë aksit rrugor Tiranë-Elbasan. Kërkesa për këtë transferim

është iniciuar nga FSHZH e cila i është drejtuar me kërkesë Ministrisë së Mbrojtjes për dijëni Kryeministrit, ku kërkohet dakordësia për realizimin e projektit.



FSHZH ndër të tjera trajton se, zona ku planifikohet investimi gjendet në gjendje të degraduar dhe ka humbur funksionin parësor atë të rezervave të shtetit dhe transformimi i kësaj hapësire është tepër i nevojshëm për ta bërë sa më të aksesueshme nga të gjithë, por dhe si pjesë integrale e zonave të banimit që janë krijuar vitet e fundit pranë kësaj zone. Impakti që pritet të ketë projekti sipas FSHZH konsiston në krijimin e një hapësire argëtuese të aksesueshme nga vizitorët por dhe banorët pranë me qëllim sigurimin e infrastrukturës në këtë zonë. Sipas po këtij institucioni, investimi do të jetë në ndërtim objekte të reja, rikonstruksioni i objekteve, ndërtimi i argjaturës për mbrojtjen e bregut të lumit, përmirësimi i peizazhit të zonës, sigurimi i aktiviteteve sportive dhe shërbimeve të tjera të nevojshme në këtë zonë.

Në vijim të procedurës së nisur për transferimin e këtij aseti publik, Ministria e Mbrojtjes ka kërkuar prononcim nga DPRMSH e cila fillimisht i është drejtuar për mendim DRRMSH-Tiranë, e cila në përgjigjen e saj ka paraqitur situatën dhe ka kërkuar të parashikohet objekti ku do të zhvendoset rezerva materiale e cila të jetë një infrastrukturë më e mirë ndërtimore dhe me kapacitete magazinuese. Në vijim Drejtori i Përgjithshëm i RMSH (i komanduar) është shprehur “*parimisht dakord*” për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit. Vlen të theksohet se të gjitha veprimet nga regjistrimi i kërkesës për prononcim së Ministrisë së Mbrojtjes deri në kthimin e përgjigjes nga DPRMSH janë ezauruar brenda një dite datë 06.10.2022. Pra institucioneve nuk u është nevojitur kohë për vlerësimin të situatës dhe kthimin e përgjigjes, pavarësisht rëndësisë që kjo vendimmarrje kishte.

Në një përgjigje të dytë, Drejtori i Përgjithshëm i RMSH (i komanduar), nëpërmjet shkresës datë 11.10.2022, vetëm disa ditë më vonë nga prononcimi i parë ka informuar Ministrinë e Mbrojtjes mbi hapësirat magazinuese të nevojshme për DRRMSH-Tiranë, duke ri-cilësuar se shprehet “*parimisht dakord*” për transferimin e pronës pranë FSHZH por me kusht që ky i fundit të ndërtojë hapësira magazinuese si dhe zyrat ku do të zhvillohet aktiviteti administrativ i DPRMSH dhe DRRMSH Tiranë brenda ambienteve ku aktualisht ndodhet Agjencia Lundër.

Ndërkohë të dyja shkresat mbi prononcimin në Ministrinë janë hartuar dhe miratuar nga vetë drejtuesi i institucionit. Vlen të theksojmë se si drejtuesi i DPRMSH ashtu dhe ai i DRRMSH-Tiranë gjenden të komanduar në këto pozicione prej disa vitesh.

Në vijim në muajin dhjetor 2022 është miratuar VKM nr. 808, datë 12.12.2022 “Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Mbrojtjes tek Fondi Shqiptar i Zhvillimit, të pronës me emërtim “Agjencia Lundër”, me vendndodhje në Lundër, Tiranë, zona kadastrale nr. 2529, dhe për një ndryshim në Vendimin nr. 413, datë 11.7.2007, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e

listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes (Drejtoria e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit)”, të ndryshuar, përcaktohet ndryshimi i përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Mbrojtjes tek Fondi Shqiptar i Zhvillimit, të pronës, për ta përdorur për ngritjen e një kompleksi argëtimi dhe sportiv.

Referuar pikës 3 të këtij vendimi FSHZH i ndalohet ndryshimi i destinacionit si dhe tjetërsimi i saj. Ndërkohë që po në vendim në pikën 4 të tij përcaktohet se FSHZH përpara marrjes në dorëzim të pronës, të lidhë akt-marrëveshje me DPRMSH, KQZ, Ministrinë e Drejtësisë (të cilat gjithashtu disponojnë të drejta administrimi), për plotësimin e nevojave të tyre sipas projektit të paraqitur nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe dakordësuar midis palëve respektive, për të garantuar vazhdueshmërinë e funksionalitetit të këtyre institucioneve.

Në zbatim të VKM-së së mësipërme është nxjerrë Urdhri i Ministrit të Mbrojtjes nr. 166 datë 08.02.2023, nëpërmjet të cilit ngarkohet Drejtuesi i Drejtoria e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit për nxjerrjen e akteve përkatëse për dorëzimin me komision dhe për transferimin në pronësi, brenda datës 15.02.2023, Fondit Shqiptar të Zhvillimit, të pronës, për ta përdorur për ngritjen e një kompleksi argëtimi dhe sportiv.

Në vijim të Urdhër të Ministrit nr. 166 datë 08.02.2023, nëpërmjet shkresës nr. 194/1 prot, datë 13.02.2023, Drejtori i Përgjithshëm i RMSH (i komanduar) njofton Drejtorinë Rajonale të Rezervave Materiale Tiranë, të marrë masa për njoftimin e institucioneve dhe subjekteve të cilat kanë në huapërdorje sipërfaqe magazinuese pranë kësaj agjencie të kryejnë lirimin e menjëhershëm të ambienteve.

Me Urdhër nr. 25 datë 13.02.2023 Drejtori i Përgjithshme i RMSH (i komanduar), në vijim të Urdhrit të Ministrit, ka ngritur komisionin për dorëzimin e pronës me vendndodhje Lundër, Tiranë.

Me shkresën nr. 194/3 prot, datë 13.02.2023, DPRMSH ka kërkuar bashkëpunimin e FSHZH në zbatim të pikës 4 të VKM nr. 808 datë 12.12.2022. Në vijim me shkresën datë 21.02.2023 DPRMSH ka informuar Ministrinë e Mbrojtjes që gjendet në pritje të bashkëpunimit të FSHZH për hartimin e akt-marrëveshjes dypalëshe me qëllim zbatimin e urdhrit nr. 166 datë 08.02.2023 të Ministrit të Mbrojtjes.

Deri më datën 12.05.2023 Ministria e Mbrojtjes, DPRMSH dhe DRRMSH-Tiranë nuk disponojnë një projekt të dakordësuar me FSHZH dhe nuk janë lidhur akt-marrëveshje për plotësimin e nevojave të rezervës materiale të shtetit. Nuk ka gjithashtu një plan të miratuar për transferimin e aktivitetit të rezervës materiale në Lundër. Referuar shkresës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë lidhur me mendimin për projektvendimin e propozuar, trajtohet se kjo pronë është pjesë e listës së pronave për të cilat nga ana e Ministria e Mbrojtjes është shprehur dakordësia për vijim e procedurave të privatizimit por shkresa citon se, nga ana e MFE nuk është miratuar fillimi i këtyre procedurave. Për sa më sipër, Agjencia Lundër, e cila me një sipërfaqe truall prej 95,320 m² dhe pozicionim mjaft të mirë, është parashikuar edhe më parë për tu privatizuar pavarësisht se ajo zë peshën kryesore në magazinimin e mallrave ushqimorë rezervë materiale e shtetit në rang kombëtar, çka tregon një qasje të paqartë të hallkave institucionale në drejtim të zhvillimit të aktivitetit të rezervës materiale në tërësi.

Kushtet e ruajtjes së mallrave dhe kapacitet përkatëse

Sipas konstatimeve në vend në ambientet e magazinimit të mallrave për të parë edhe kushtet e ruajtjes të tyre të cilat u shtrinë në të gjitha Drejtoritë Rajonale, kryesisht në qendrat ku kryhej aktiviteti kryesor i tyre. Theksojmë se mallrat ushqimorë janë të qendëruar në DRMSH-Tiranë ndërsa pranë drejtorive rajonale gjenden mallra industriale pjesë të rezervës materiale por gjithashtu dhe mallra pjesë e sekuestrimeve apo konfiskimeve të ndryshme. Sipas vëzhgimit në terren por

edhe përgjigjeve zyrtare, DRRMSH-Tiranë disponon dy magazina të favorshme për magazinim mallrash me Sip. Totale 2008 m². Kushtet e ruajtjes së mallrave jo-ushqimorë në drejtoritë rajonale, jo në të gjitha rastet ishin optimale, kjo për shkak të mungesës së investimeve për rikonstruksionin dhe mirëmbajtjen e magazinave të shfrytëzuara. Gjithashtu një pjesë e konsiderueshme e mallrave kryesisht veshje, apo mallra të konfiskuara, ishin të pa-paketuara dhe nuk gjendeshin në kushte optimale për përdorim.



Burimi: Grupi i auditimit

Kapacitetet magazinuese aktuale të rezervës materiale në nivel kombëtar paraqiten si më poshtë vijon:

Tabela nr.5 Kapacitetet e disponueshme nga rezerva materiale e shtetit

Nr.	Drejtoria Rajonale	Ambiente magazinimi	Sipërfaqja magazinuese m ²	Vëllimi në m ³
1	Tiranë	22	9,688	38,848
2	Dibër	3	3,119	12,476
3	Korçë	3	1,964	7,855
4	Shkodër	3	1,906	7,624
5	Fier	3	489	2,012
Shuma		34	17,166	68,815

Burimi: DPRMSH, përpunuar nga grupi i auditimit

Pjesën kryesore të kapaciteteve magazinuese e zë DRRMSH-Tiranë e cila zë peshën kryesore me rreth 50% të saj dhe gjenden të shtrira në rrethet Tiranë, Elbasan dhe Durrës, ndërsa drejtoria me kapacitetet më të vogla magazinuese paraqitet DRRMSH-Fier. Sa i përket aspekteve të sigurisë, ajo realizohet nëpërmjet rojeve pjesë e strukturës së drejtorive rajonale megjithatë, numri i tyre, magazinave, territori i gjerë ku ato shtrihen paraqesin një situatë aspak të favorshme në këtë drejtim. Rezerva materiale e shtetit veç mallrave rezervë, mallrave që vijnë si ndihmë humanitare dhe aseteve nën përgjegjësi të vetë, administron edhe mallrat që kalojnë në pronësi të shtetit nga kundërvajtjet administrative dhe kryerja e veprave penale. Këto të fundit e kanë burimin kryesisht nga konfiskimet e kryera nga organet tatimore dhe doganore, gjykatës në rastet e konstatimit të veprave penale si dhe nga vendimet administrative për konfiskim të marra nga policia e shtetit në rastet e tejkalimit të afateve të pagesës së gjobave për mjetet e transportit etj.

Aktualisht numri i konfiskimeve të kryera nga organet fiskale është i pakët pas ndryshimeve në legjislacionin tatimor në fund të vitit 2019 duke zëvendësuar konfiskimin e mallrave me aplikimin e rivlerësimeve dhe penaliteteve. Për mënyrën e marrjes në dorëzim të mallrave nga DPRMSH, Këshilli i Ministrave ka miratuar Udhëzimin nr.1 datë 18.02.2015, për mallrat blerë me fonde buxhetore, atyre të transferuara pa pagesë/ mallra të dhuruar, dhe atyre të konfiskuar.

Administrimi i mjeteve


Rezerva materiale e shtetit administron një numër të lartë mjeteve të cilat janë të konfiskuara por edhe të përcjella në ruajtje nga prokuroritë e rretheve. Ligji nr. 9900 datë 10.04.2008 “Për rezervën materiale të shtetit”, Ligji i nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, përcaktojnë kalimin e mjeteve të konfiskuara në rezervën materiale të shtetit. Veç tyre sipas Kodit Penal me vendim të gjykatës bëhet konfiskimi i mjeteve të kryerjes së veprës penale dhe produkteve të veprës penale dhe kalimi i tyre në favor të shtetit. Kalimi i rezervës materiale nën fushën e përgjegjësisë të Ministrisë së Mbrojtjes, është pasuar me miratimin e një udhëzimi të përbashkët mes saj dhe Ministrisë së Brendshme përkatësisht Udhëzimin nr. 1 datë 09.01.2019, “Për procedurat e kalimit të automjeteve dhe moto mjeteve nga mjediset e drejtorive rajonale të policisë së shtetit dhe ato të policisë kufitare dhe migracionit tek drejtoritë rajonale të rezervave materiale të shtetit”, me qëllim unifikimin e procedurave që ndiqen në këto raste. Deri në miratimin e këtij akti, për rreth një vit është vijuar aktiviteti me udhëzimin e Ministrit të Brendshëm të vitit 2014. Nga të dhënat e paraqitura, situata e mjeteve pranë rezervave materiale të shtetit paraqitet si vijon:

Tabela 6 Mjete të administruara në rezervat materiale të shtetit

MJETE TE ADMINISTRUARA NGA REZERVA MATERIALE E SHTETIT				
Drejtoritë Rajonale	Në Ruajtje (copë)	Të kategorizuara për skrap dhe miratuar për shitje (copë)	Të kategorizuara për skrap dhe të pa miratuara për shitje (copë)	Të pa kategorizuara (copë)
DRRMSH Tiranë	162	1355	141	169
DRRMSH Dibër	0	339		164
DRRMSH Shkodër	21	265	31	16
DRRMSH Fier	1	380		241
DRRMSH Korçë	4	272		170
Totali	188	2,611	172	760

Burimi: DPRMSH, përpunuar nga grupi i auditimit

Grafiku nr. 3 Situata e mjeteve pranë RMSH



Nga vëzhgimet e kryera në terren pranë drejtorive rajonale, rezultoi se mjetet ishin të përhapura thuajse të gjithë territorin e magazinave kryesore. Numri i lartë i tyre dhe territori i kufizuar krijonte kufizime për mirëmbajtjen e territorit dhe mirë administrimin e tij. Në disa raste mjetet ruheshin edhe brenda magazinave bosh me qëllim mirëmbajtjen sadopak të tyre. Periudha e gjatë nën efektin e agjentëve atmosferikë e kishte përshpejtuar së tepërmi amortizimin e tyre. Situata paraqitej problematike thuajse në të gjitha DRRMSH-të.

Foto të dy ambienteve në DRRMSH ku ruhen mjetet.



Burimi: Grupi i auditimit

Sa i përket aspekteve rregullatorë, në udhëzimin e përbashkët të nënshkruar mes dy ministrave, pika 8 e tij trajton se, në rast se pas shitjes së mjetit të konfiskuar me gjobën e vendosur ka një diferencë pozitive, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë ia kthehen atë shkelësit, ndërsa në rastin që kjo diferencë është negative, vlera e shitjes konsiderohet si detyrim përfundimtar.

Referuar informacionit të disponuar, procedura e kthimit të vlerës nuk rezulton të jetë vënë ende në funksion pasi, mjetet kanë një kohë relativisht të gjatë pa u shitur në ankand. Sa i përket trajtimit në udhëzim të vlerës së shitjes si e ardhur përfundimtare, në rastet kur vlera e gjobës është më e lartë, në vlerësimin tonë gjendet e pambështetur për aq kohë sa detyrimi i gjobës buron nga ligji dhe po në ligj duhen përcaktuar rastet kur ky penalitet mund të reduktohet apo të shuhet.

Për përcaktimin e peshës reale fizike të mjeteve motorikë me Urdhrin e Ministrit nr. 1054 datë 08.07.2019 është miratuar manuali përkatës i cili përcakton koeficientet në (%) të metaleve me ngjyrë, pjesëve të cilat nuk përfshihen në kategorinë e skrapit si xhama, pjesë plastike, tapiceri etj. Referuar sa më sipër, pjesët e mjeteve të cilat nuk përfshihen në kategorinë e skrapeve nuk janë pjesë e vlerës së shitjes por ato kalojnë së bashku me mjetin dhe transferohen pa pagesë tek fituesi i ankandit, pavarësisht se mund të shërbejnë si pjesë këmbimi apo mund të jenë materiale të riciklueshme si në rastin e pjesëve plastike, por jo vetëm. Në rastin e mjeteve me vit të ri prodhimi me problematika të cilat nuk kategorizohen për qarkullim, vlerat e këtyre pjesëve janë të më të larta se vetë vlera e skrapit.

Në vijim Ministri i Mbrojtjes ka miratuar Udhëzimin nr. 6 datë 17.05.2019, “Për procedurat që ndiqen për administrimin e automjeteve dhe moto mjeteve që kalojnë në rezervat materiale të shtetit si pasojë e konfiskimit”. Në këtë udhëzim janë përcaktuar detyrat e njësive përgjegjëse, kategorizimin i) mjete që plotësojnë kushtet për qarkullim dhe ii) mjete që do të administrohen për skrap, mënyrën e përcaktimit të peshës reale fizike të mjeteve dhe kontabilizimit të tyre, si dhe veprimet e mëtejshme në këtë procedurë. Procedurat e shitjes i nënshtrohet kuadrit ligjor për ankandin publik. Në rast se mjetet që plotësojnë kushtet për qarkullim, i janë nënshtruar procedurave të ankandit publik por procedurat e ankandit kanë dështuar atëherë ato sipas këtij udhëzimi trajtohen për skrap. Mbetet i rëndësishëm të veçojmë se, përpara shitjes në ankand të mjeteve të cilat janë Aktive Afatgjatë Materiale, duhet të kryhet në rend shterues vlerësimi i

nevojave brenda strukturave të RMSH dhe më tej në njësitë e tjera publike, për të qenë koherent edhe me Udhëzimit nr.1 datë 18.02.2015 të këshillit të Ministrave pika 8 e tij.

Tabela nr.7 Mjete të transferuara në institucione të tjera shtetërore

Periudha	Njësia	Numri i Mjete te transferuar institucioneve te tjera shtetërore
2019	Copë	1
2020	Copë	21
2021	Copë	15
2022	Copë	10
01-04/2023	Copë	7
Totali		54

Burimi: DPRMSH, përpunuar nga grupi i auditimit

Nga 54 mjetet e mësipërme të transferuara në institucione të tjera, 26 prej tyre u janë transferuar 10 bashkive të vendit, ndërsa pjesa tjetër në institucione të ndryshme qendrore dhe të varësisë. Transferimi i mjeteve do të kursente vlera të konsiderueshme buxhetore për institucionet publike por në këtë drejtim nevojiten akte rregullatorë më specifike, për mënyrën si duhet të veprojnë njësitë publike kërkesat e tyre, procesin vlerësues dhe krahasimor të nevojave dhe më tej, transferimin e mjeteve pranë institucioneve përfituese.

-Ndjekja e procedurave periodike të inventarizimit, vlerësimit dhe asgjësimit

Nga të dhënat e paraqitura nga subjektet nën auditim rezulton se, procesi i inventarizimit të aktiveve është kryer përpara mbylljes së pasqyrave financiare vjetore. Prosesi i fundit e inventarizimit sipas të dhënave të DRRMSH-ve është realizuar në muajin tetor 2022. Procedurat e inventarizimit dhe vlerësimit bazohen në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, si dhe akteve përkatëse të Ministrit të Mbrojtjes për rregullimin e brendshëm të kësaj veprimtarie. Më poshtë paraqiten procedurat e asgjësimit të disa mallrave kryesisht të përfituara nga proceset e konfiskimit. Risk më të lartë për proceset e inventarizimit, vlerësimit dhe asgjësimit të mallrave e mbart DRRMSH Tiranë e cila ka një numër të lartë artikujsh të rezervës materiale si dhe të mallrave të sekuestruar e konfiskuar pasi kjo DRRMSH përfshin edhe rrethet e Elbasanit dhe Durrësit. Një pjesë e konsiderueshme e mallrave që përftohen konfiskimi dhe vlerësohen për shitje nuk arrijnë të shiten në ankandet e zhvilluara çka me kalimin e kohës apo nën efektin e kushteve të papërshtatshme të ruajtjes dhe mirëmbajtjes të humbasin vetitë e tyre dhe të kthehen në mallra për tu asgjësuar.

Tabela nr.8 Procedurat e asgjësimit të mallrave

PROCEDURAT E ASGJESIMIT TE MALLRAVE					
Drejtoria Rajonale	2019	2020	2021	2022	Gjithsej procedura
DRMSH Korçë		2	3		5
DRMSH Dibër	1	1			2
DRMSH Fier		7	2		9
DRMSH Shkodër		2	3		5
DRMSH Tirane		1	1	2	4
Shuma	1	13	9	2	25

Burimi: DPRMSH, përpunuar nga grupi i auditimit

-Ankandet publike të zhvilluara

Në rastet e parashikuara nga neni 10 i ligjit nr. 9900 datë 10.04.2008 “Për rezervat materiale të shtetit”, DPRMSH siguron të ardhura në buxhetin e shtetit nga shitja në ankand e mallrave të konfiskuara, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 9874, datë 14.02.2008 “Për ankandin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 1719, datë 17.12.2008 “Për miratimin e Rregullave të Ankandit Publik”, i ndryshuar. Për periudhën vitet 2019-2022 situata e ankandëve paraqitet si më poshtë vijon:

Tabela nr.9 Ankandet e zhvilluara

Institucioni	Viti 2019		Viti 2020		Viti 2021		Viti 2022	
	Nr. Proc	Vlera në lekë	Nr. Proc	Vlera në lekë	Nr. Proc	Vlera në lekë	Nr. Proc	Vlera në lekë
DPRMSH		-	-	-	-		9	3,758,206
DRMSH Tiranë	16	4,470,722	8	1,657,939	20	5,908,051	17	2,818,202
DRMSH Korçë	12	939,595	2	13,024,429	13	-	6	302,141
DRMSH Shkodër	24	6,364,632	20	1,036,067	20	267,638	10	24,064
DRMSH Dibër	1	22,320	1	14,700	-	-	2	-
DRMSH Fier	12	1,076,870	3	57,500	6	195,179	3	-
Gjithsej	65		34		59		38	
Procedura të suksesshme	15	12,874,139	13	15,790,635	11	6,370,868	14	6,902,613

Burimi: DPRMSH, përpunuar nga grupi i auditimit

Bazuar në të dhënat e siguruar, të pasqyruara më sipër mesatarisht përfundojnë me sukses 13 procedura të shpallura, ndërkohë që të ardhurat e përfituara janë minimale, krahasuar me stafin e nevojshëm i cili angazhohet nga të gjitha drejtoritë.

Kontratat e mallrave dhe inspektimi i tyre

Në funksion të zhvillimit të aktivitetit të rezervës materiale të shtetit me qëllim miradministrimin e saj, kryhet edhe procesi i freskimit të mallrave rezervë, i cili bëhet nëpërmjet këmbimit ose huadhënies, me anë të aktmarrëveshjeve, të lidhura me institucione, që financohen nga Buxheti i Shtetit, të kontratave dypalëshe, të lidhura me subjekte private, që kanë kontrata të ngjashme furnizimi për këto mallra, si dhe me anë të shitblerjes.⁵⁰

Gjithashtu për artikujt e rezervave materiale të shtetit, që kërkojnë kushte të veçanta mirëmbajtjeje, Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit mund të kontraktojë për depozitimin e tyre me agjentë ekonomikë, të cilët plotësojnë kushtet teknike, të nevojshme dhe të domosdoshme, për të siguruar pandryshueshmërinë e gjendjes cilësore dhe vëllimore të artikujve rezervë materiale të shtetit.⁵¹

Në kuadër të përcaktimeve të mësipërme DPRMSH për gjatë periudhës objekt auditimi 2019-2022, ka lidhur, Akt Marrëveshje, Kontrata Depozitimi dhe Kontrata Shitblerje si më poshtë vijon:

- Për vitin 2019 2 Akt Marrëveshje freskimi me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve
4 Kontrata Depozitimi pranë të tretëve subjekte tregtare’.
- Për vitin 2020 (nuk ka kontrata të lidhura)
- Për vitin 2021 1 Akt Marrëveshje freskimi me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve
1 Kontrata Shitblerje Amendament lidhur me depozitimin me subjekte tregtare.
- Për vitin 2022 3 Akt Marrëveshje freskimi me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve
2 Amendamente me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve
10 Kontrata Shitblerje me subjekte tregtare

⁵⁰ Ligji nr. 9990, datë 10.04.2008 "Për rezervat materiale të shtetit", i ndryshuar, neni 12, pika 2.

⁵¹ Ligji nr. 9990, datë 10.04.2008 "Për rezervat materiale të shtetit", i ndryshuar, neni 16, pika 1.

Kontratat Depozitë janë lidhur midis DPRMSH dhe subjekteve tregtare gjatë vitit 2019, për mallra ndihmë humanitare, të cilat për shkak të kushteve të veçanta të ruajtjes janë depozituar pranë të tretëve.

Kontratat Depozitë, kanë në përbërjen e tyre elementët e mëposhtëm:

- ✓ Objekti i kontratës- Garantimi i gjendjes cilësore të artikullit me qëllim ruajtje e mirëmbajtje
- ✓ Të drejtat dhe detyrimet e palëve.
Shoqëria tregtare garanton mirëmbajtjen dhe ruajtjen e sasisë pa shpërblim.
N.q.s. sasia e depozituar përdoret pa pëlqimin e DPRMSH, atëherë subjekti tregtar është përgjegjës për humbjen ose dëmtimin e tij deri në shkakun faktor.
Subjekti tregtar duhet të ruajë sasinë e depozituar veçmas nga mallrat e tjerë dhe duhet ta pajisë këtë mall me shenja dalluese që të tregojnë përkatësinë e tij ndaj DPRMSH.
DPRMSH ka të drejtë të inspektojë sasinë dhe të tërheqë kampionë e përdorimit.
- ✓ Vlefshmëria e kontratës- Kontrata është e vlefshme duke filluar nga data e dorëzimit të sasisë dhe nënshkrimit të saj e deri në kthimin në natyrë të gjithë sasisë te DPRMSH
- ✓ Në disa raste vlefshmëria e kontratës nuk përmban afate të përcaktuara.

Kontratat Depozitë të lidhura gjatë vitit 2019, kanë qenë për mallrat të ardhura si donacion, të cilat kanë qenë shoqëruar me certifikatë ose janë kryer analiza lidhur me cilësinë nga ana e DPRMSH para depozitimit të mallit të subjekti tregtar.

Kontratat e Shitblerjes midis DPRMSH dhe subjekteve tregtare i referohen blerjes së mallrave të klasifikuara rezervë materiale shtetërore sipas përcaktimeve të VKM Nr.1128, datë 05.08.2008 “Për krijimin dhe administrimin e mallrave rezervë materiale shtetërore”, i ndryshuar.

Ato bazohen në procedurën e prokurimit të zhvilluar nga Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara dhe marrëveshjet kuadër të cilat janë lidhur midis DPRMSH dhe subjekteve tregtare fituese të konkurrimit. Kontratat e Shitblerjes kanë në përbajtje të tyre mallrat të cilat merren në dorëzim dhe magazinohen pranë DRRMSH Tiranë, si edhe mallrat të cilat për shkak të kushteve të veçanta të ruajtjes dhe mirëmbajtjes qëndrojnë pranë të tretëve. Lidhur me këto kontrata evidentohet se, pavarësisht se lloji i kontratës së përdorur është “Marrëveshje Kuadër”, me afat një vit. Aktualisht kjo kontratë trajtohet si një kontratë e zakonshme prokurimi duke mos shfrytëzuar avantazhet që jep përdorimi i saj lidhur me furnizimin e mallrave sa herë lind nevoja dhe jo në mënyrë të menjëhershme. Zbatimi efektiv i “Marrëveshjes Kuadër” do të garantonte përdorimin me ekonomikitet të fondeve referuar nevojave por gjithashtu do të lejonte menaxhimin më të mirë të rezervës materiale nëpërmjet thjeshtimit të procedurave. Një element gjithashtu i rëndësishëm në “Marrëveshjen Kuadër” është edhe afati i kontratës, i cili do të mundësonte një siguri më të lartë në aktivitetin e rezervës materiale të shtetit për shkak të garancisë lidhur me kontraktorin.

Procedurat e ndjekura pas lidhjes së kontratës së shit-blerjes trajtohen si më poshtë:

-Shkresë e Drejtorit të Përgjithshëm të DPRMSH drejtuar DRRMSH Tiranë, për njohje dhe zbatim të kontratës së shit blerjes të lidhur me objekt: Blerje ushqime koloniale rezervë shteti.

-Urdhër i Drejtorit të Përgjithshëm të DPRMSH “Për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të artikujve ushqimorë rezervë shteti”.

Marrja në dorëzim e mallrave objekt kontrate për mallrat që vijnë fizikisht në DRRMSH-Tiranë kryhet sipas procedurës së zakonshme të dorëzimit. Sa i përket mallrave të cilat që sipas përcaktimeve të kontratave ruhen pranë shitësit, marrja në dorëzim e tyre bëhet “*de jure*” nga komisioni i ngritur për këtë qëllim. Këto mallra referuar kontratës janë objekt inspektimi nga DPRMSH ndërkohë që gjenden nën përgjegjësinë materiale të DRRMSH-Tiranë sa i përket sasisë dhe kushteve në të cilat ato ruhen. Praktika e deritanishme, në mungesë dhe të akteve rregullative, evidenton paqartësi mbi rolet dhe përgjegjësinë e secilës strukturë në garantimin e gjendjes dhe sasisë së mallit.

1. Gjetje nga auditimi: Gjendja e mallrave rezervë materiale shtetërore është nën kufijtë e përcaktuara në VKM nr.1128 datë 05.08.2008 “Për krijimin dhe administrimin e mallrave rezervë materiale shtetërore”, e ndryshuar, çka ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në përgjigjen ndaj përballimit të situatave jo të zakonshme me të cilat mund të përballet vendi.

- Për artikujt e grupit A: “Mjete të rënda për çdo lloj transporti” gjendja është nën vlerat orientuese dhe kufirin minimal dhe për artikullin “Grurë” gjendja është zero.
- Për artikujt e grupit B: “Mjete të vogla lundrimi, dhe Karburante”, gjendja është zero, ndërsa për automjete të tonazhit të ulët nën 10 ton, gjendja është nën vlerat orientuese dhe kufirin minimal.
- Për artikujt e Grupit C: nga 22 artikuj, 20 prej tyre janë me diferenca, mungesa jo vetëm te gjendja orientuese e mallrave (sasia) por edhe nën vlerat e kufijve minimal të përcaktuara në VKM.

Sasia e përgjithshme e mallrave gjendje për disa mallra është zvogëluar. Diferencat nga limiti minimal për një pjesë të konsiderueshme mallrash janë të ndjeshme. Rezerva materiale e shtetit nuk garanton nevojat e qytetarëve në përballimin e rasteve të emergjencave civile dhe rasteve të tjera të parashikuara.

1.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit në bashkëpunimin me Ministrinë e Mbrojtjes të marrin masa për plotësimin e sasisë së mallrave sipas përcaktimeve në VKM nr.1128 datë 05.08.2008 “Për krijimin dhe administrimin e mallrave rezervë materiale shtetërore”, e ndryshuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Gjendjet orientuese dhe kufijtë minimal për produktet bazë janë mbajtur në të njëjtat nivele që prej vitit 2008, duke mos reflektuar dinamikën e zhvillimit dhe situatat me të cilat është përballur vendi vitet e fundit si tërmeti i vitit 2019, pandemia globale etj. Ndryshimet në nomenklaturën e mallrave rezervë shteti, janë kryer mbi një kuadër rregullator të parashikuar së fundmi për mbrojtjen civile dhe pa një metodologji të caktuar, referuar rëndësisë, burimeve të financimit, ndryshimit të numrit të popullsisë, ndryshimeve demografike, etj.

2.1 Rekomandimi: Ministria e Mbrojtjes në bashkëpunimin me Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit të marrin masa për rishikimin e nomenklaturës, sasisë dhe gjendjes së mallrave rezervë shteti mbi bazën e një metodologjie të mirë përcaktuar, me qëllim garantimin e nevojave të qytetarëve në rastet e situatave jo të zakonshme.

Brenda vitit 2023

3. Gjetje nga auditimi: Rezerva materiale e shtetit ka 25 prona të paluajtshme të regjistruara pranë zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, ndërsa për 27 të tjera të cilat përbëhen nga 933,690 m² “Troje” dhe 58,989 m² “Ndërtime” procesi i regjistrimit nuk rezulton të ketë përfunduar. Këto prona shtrihen në të gjitha drejtoritë rajonale. Pjesa më e madhe e pronave të paregjistruara në numër dhe sipërfaqe paraqitet në Drejtorinë Rajonale, Tiranë e cila rezulton me 18 të tilla dhe Korçë me 4 prona. Pronat nën përgjegjësi administrimi të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit janë të përcaktuara qartësisht në VKM nr. 413 datë 11.07.2007, i ndryshuar. Zgjatja e procesit të regjistrimit, burimet njerëzore dhe financiare të kufizuara për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e tyre krijojnë risk të lartë për dëmtimin dhe tjetërsimin e këtyre aseteve pasuri kombëtare.

3.1 Rekomandimi: Ministria e Mbrojtjes, nëpërmjet një grupi pune, të verifikojë problematikat e hasura për mos regjistrimin e pronave nën administrimin e rezervës materiale të shtetit dhe të ndërmarrë veprimet përkatëse për adresimin e tyre.

Brenda vitit 2023

4. Gjetje nga auditimi: Pronat të cilat Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit administron përcaktohen në VKM nr. 413 datë 11.07.2007, të ndryshuar. Ndër vite këto asete janë përdorur në disa forma dhe përkatësisht 2 (dy) prona i janë nënshtruar procesit të shitjes, 2 (dy) prona janë dhënë me qira me çmimin simbolik 1 Euro, 2 (dy) prona janë dhënë me qira 1 vjeçare nga DPRMSH, 1 (një) pronë është kaluar pranë Agjencisë së Trajtimit të Pronave për tu përdorur fond kompensimi si dhe 5 (pesë) prona janë transferuar në institucione të tjera sipas vendimeve përkatëse të Këshillit të Ministrave. Territori dhe ndërtesat e njësisë kryesore të rezervës materiale me vendndodhje në Lundër, Tiranë, e cila është përgjegjëse për administrimin e mallrave ushqimorë në rang kombëtar, me VKM nr. 808, datë 12.12.2022 i kanë kaluar në përgjegjësi administrimi Fondit Shqiptar të Zhvillimit, me qëllim ngritjen e një kompleksi argëtues dhe sportiv. Pavarësisht sa më sipër, procedura për zhvendosjen ka nisur prej muajit Shkurt 2023 por ende nuk ka gjetur zbatim.

4.1 Rekomandimi: Ministria e Mbrojtjes në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit, nëpërmjet një grupi pune, të kryejë vlerësimin e situatës, nevojave dhe kapaciteteve të nevojshme të magazinimit dhe territorit që rezerva materiale e shtetit duhet të ketë në funksion të aktivitetit të saj, për përdorimin në mënyrë sa më efektive të aseteve në shërbim të interesit publik.

Brenda vitit 2023

4.2 Rekomandimi: Ministria e Mbrojtjes të marrë masat e nevojshme për garantimin e vazhdimësisë së aktivitetit të rezervës materiale ushqimore e cila gjendet në Lundër, Tiranë, për të mos u përballur me situata të paplanifikuara dhe të pavlerësuara paraprakisht.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Kushtet e ruajtjes së mallrave të sekuestruar dhe konfiskuar jo në të gjitha rastet ishin optimale, kjo për shkak të mungesës së investimeve për rikonstruksionin dhe mirëmbajtjen e magazinave të shfrytëzuara. Gjithashtu një pjesë e konsiderueshme e mallrave kryesisht veshje, apo mallra të konfiskuara, ishin të pa-paketuara dhe nuk paraqiteshin në gjendeshin në kushte optimale për përdorim. Ndërkohë automjetet ishin të përhapura në të gjithë territorin rreth magazinave kryesor. Për ato të kategorizuara për skrap periudha e gjatë nën efektin e agjentëve atmosferikë e kishte përshpejtuar së tepërmi amortizimin e tyre. Kjo situatë paraqitej thujse në të gjitha DRRMSH-të, si rezultat i mos përfundimit ende të procedurave të shitjes së tyre. Mosveprimi në kohë krijon mbingarkesa të panevojshme për stafin e rezervës materiale në drejtim të administrimit të mallrave por edhe ndikon negativisht në përfitimet që mund të vijnë nga shitja në kohë e tyre.

5.1 Rekomandimi: Ministria e Mbrojtjes dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit të marrin masat e nevojshme për vlerësimin dhe shitjen në kohë të mallrave të konfiskuara gjendje me qëllim përfitimin e vlerave sa më të larta në shitjen e tyre si dhe reduktimin e veprimeve administrative.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Kuadri rregullator mbi të cilin bazohet administrimi i mjeteve shfaq disa dobësi dhe konkretisht, manuali i cili përcakton peshën reale fizike të mjeteve nuk trajton në asnjë rast pjesët jo-metalike të mjetit, të cilat transferohen së bashku me mjetin. Pavarësisht se Udhëzimi nr.1 datë 18.02.2015 i Këshillit të Ministrave përcakton një rend shterues për trajtimin e mjeteve, duke plotësuar fillimisht nevojat e rezervës materiale të shtetit dhe më tej në institucionet e tjera publike, por ende nuk disponohet një mekanizëm i qartë mbi adresimin e kërkesave dhe mënyrën e trajtimit të tyre. Veç sa më sipër, në udhëzimin e përbashkët midis Ministrisë së Mbrojtjes dhe asaj të Brendshme evidentohet se në rast se pas shitjes së mjetit të konfiskuar me gjobën e vendosur ka

një diferencë pozitive, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë ia kthehen atë shkelësit, ndërsa në rastin që kjo diferencë është negative, vlera e shitjes konsiderohet si detyrim përfundimtar. Mekanizmi i kthimit të vlerave ende nuk rezulton të jetë bërë efektiv ndërsa sa i përket shuarjes së detyrimit, vlerësojmë se kjo është një kompetencë e cila vendoset me ligj për aq kohë sa penalteti buron po nga ligji.

6.1 Rekomandimi: Ministria e Mbrojtjes pas vlerësimit të situatës, të marrë masat e nevojshme për rishikimin e kuadrit ligjor e rregullator mbi administrimin e mjeteve të konfiskuara.

Brenda vitit 2023

7. Gjetje nga auditimi: Në kontratat e përdorura nga DPRMSH për blerjen dhe ruajtjen e mallrave rezervë materiale e shtetit evidentohet se:

Kontratat Depozitë lidhur midis DPRMSH dhe agjentëve ekonomike (subjekteve tregtare), në mënyrën si janë konceptuar nuk garantojnë sasinë, ruajtjen dhe mirëmbajtjen e mallrave rezervë materiale shtetërore. Përzgjedhja e subjekteve që shërbejnë si depozitarë nuk është kryer si përcaktohet në mënyrë që të sigurohet pandryshueshmëria e gjendjes cilësore dhe vëllimore të artikujve rezervë material e shtetit⁵². Kontratat Depozitë nuk kanë të përcaktuara afatet e kohëzgjatjes të depozitimit të mallit pranë depozitarit si edhe penaltetet në rast të humbjes apo dëmtimit të mallit rezervë material shtetërore si përcaktohet⁵³. Në të gjitha rastet e kontratave depozitë të lidhura, shoqëria tregtare garanton mirëmbajtjen dhe ruajtjen e sasisë pa shpërblim.

7.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit të marrë masa për hartimin e kuadrit rregullator, i cili të përcaktojë qartë kriteret e përzgjedhjes së agjentëve ekonomikë me të cilët do të lidhen Kontratat Depozitë për mallrat rezervë materiale e shtetit që kërkojnë kushte të veçanta për ruajtjen dhe mirëmbajtjen.

Brenda vitit 2023

7.2 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit të marrë masa për hartimin e Kontratës Depozitë tip në rastin e magazinimit të mallrave rezervë materiale e shtetit pranë të tretëve, duke marrë në konsideratë përfshirjen e elementëve të munguar, të cilët rrisin përgjegjësinë e agjentëve ekonomikë për të garantuar mirëmbajtjen dhe ruajtjen e sasisë.

Brenda vitit 2023

8. Gjetje nga auditimi: Për Kontratat e Shit-Blerjes lloji i kontratës së përdorur është “Marrëveshje Kuadër”, me afat një vit, ku procedurat e prokurimit realizohen nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara. Aktualisht kjo kontratë trajtohet si një kontratë e zakonshme prokurimi duke mos shfrytëzuar avantazhet që “Marrëveshja Kuadër” jep lidhur me furnizimin e mallrave sa herë lind nevoja dhe jo në mënyrë të menjëhershme dhe përdorimin me ekonomikitet të fondeve. Aplikimi i një afati më të gjatë se një vit do të mundësonte një siguri më të lartë në aktivitetin e rezervës materiale të shtetit për shkak të garancisë lidhur me kontraktorin.

8.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit të përdorë të gjitha avantazhet e “Marrëveshjes Kuadër” sa i përket blerjes së mallrave rezervë materiale si dhe ti drejtohet Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara, për përdorimin e një afati më të gjatë, me qëllim përdorimin me ekonomikitet të fondeve publike, shkurtimeve e procedurave, si dhe garantimit të gjendjes dhe sasisë së mallrave.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Gjatë kohës që mallrat kanë qëndruar në magazinat e agjentëve ekonomikë, nuk është kryer asnjë inspektim apo tërheqje e kampionëve të e përdorimit, nga ana e

⁵² Ligji nr. 9990, datë 10.04.2008 "Për rezervat materiale të shtetit", i ndryshuar, neni 16, pika 1.

⁵³ Ligji nr. 9990, datë 10.04.2008 "Për rezervat materiale të shtetit", i ndryshuar, neni 16, pika 2.

DPRMSH. Në përfundim mungon një kuadër rregullator i qartë dhe i plotë i cili përcakton kriteret e përzgjedhjes së agjentëve ekonomikë të cilët do të shërbejnë si depozitarë të mallrave rezervë materiale e shtetit të cilat për shkak të kushteve të veçanta të ruajtjes dhe mirëmbajtjes, duhet të magazinohen pranë të tretëve.

Në kontratat e lidhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit me subjekte tregtare, si Kontrata Depozitë ashtu edhe Shitblerje, megjithëse përgjegjësinë për kryerjen e inspektimeve dhe tërheqjen e kampionëve e ka DPRMSH, përgjegjësia materiale për mallrat rezervë materiale e shtetit qëndron te Drejtoria Rajonale e Rezervës Materiale të Shtetit Tiranë, e cila është përgjegjëse për inventarizimin e mallrave.

9.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit të hartojë kuadrin rregullator për përcaktimin e periodicitetit të kryerjes të inspektimeve dhe mekanizmin për monitorimin e tij, për mallrat rezervë materiale e shtetit që kërkojnë kushte të veçanta për ruajtjen dhe mirëmbajtjen dhe depozitohen pranë të tretëve.

Brenda vitit 2023

9.2 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit të përfshijë si Kontrata Depozitë ashtu edhe Shitblerje edhe Drejtorinë Rajonale të Rezervave Materiale të Shtetit Tiranë, në cilësinë e monitoruesit dhe inspektuesit, si strukturë me përgjegjësi materiale.

Brenda vitit 2023

Konkluzione:

1. Legjislacioni aktual i parashikuar, fondet buxhetore të parashikuara për rezervë materiale, ndryshimet në nomenklaturën e mallrave të kryera pa një metodologji të caktuar dhe analiza konkrete, bëjnë që krijimi dhe administrimi i rezervave materiale të shtetit të përballet gjithmonë me çështje kontradiktore që sjellin mungesa në artikujt e rezervës, vonesa në vendimmarrje dhe vështirësojnë miradministrimin e tyre.
2. Institucionet e përfshira pavarësisht kohës së gjatë nuk kanë arritur të përmbushin detyrimin për regjistrimin e plotë të pronave, pavarësisht se ka një vendim të Këshillit të Ministrave i cili ngarkon institucionet respektive për regjistrimin e tyre. Nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit nuk ka qartësi mbi mënyrën se si do të administrohen pasuritë e paluajtshme të rezervave materiale të shtetit.
3. Kryerja e aktivitetit dytësor për ruajtjen dhe shitjen e mallrave të sekustruara dhe konfiskuara evidenton nevojën për rishikim të përgjithshëm të veprimtarisë së rezervës materiale, për të mos lënë hapësira në përmbushjen e aktivitetit kryesor të rezervës materiale të shtetit. Evidentohet nevoja për rishikim të kuadrit ligjor dhe rregullator të cilat rregullojnë administrimin e mjeteve të konfiskuara.
4. Mungesa e sigurisë lidhur me pandryshueshmërinë e gjendjes cilësore dhe vëllimore të mallrave rezervë materiale e shtetit, mungesa e penaliteteve në kontratë ndryshe nga sa përcaktohet, garantimi i mirëmbajtjes dhe ruajtjes së sasisë pa shpërblim nga ana e agjentëve ekonomikë, ul nivelin e përgjegjësisë dhe krijon risk të lartë në përmbushjen e qëllimit të krijimit dhe misionit të RMSH.
5. Zbatimi efektiv i “Marrëveshjes Kuadër” do të garantonte përdorimin me ekonomicitet të fondeve referuar nevojave por gjithashtu do të lejonte menaxhimin më të mirë të rezervës materiale nëpërmjet thjeshtimit të procedurave.

6. Mos përfshirja e Drejtoria Rajonale të Rezervës Materiale të Shtetit, Tiranë si strukturë me përgjegjësi materiale në procesin e inspektimit dhe monitorimit të kontratave të mallrave RMSH pranë të tretëve, krijon paqartësi mbi detyrimet respektive të institucioneve.

4.2.2 A ka funksionuar sistemi i raportimit, monitorimit dhe koordinimit mes institucioneve të përfshira?

Ligji nr.9900, datë 10.04.2008 “Për rezervat materiale të shtetit” i ndryshuar në nenin 6 pika 5 e tij përcakton detyrimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit për drejtimin dhe kontrollin e veprimtarisë të degëve të saj rajonale. Një rol të rëndësishëm në këtë drejtim e zë veprimtaria e Drejtorit të Përgjithshëm i cili referuar nenit 7 të po këtij ligji, ushtron kompetenca si, nxjerrja e urdhrave për veprimtarinë e strukturave të saj, bashkërendimi i veprimtarisë me institucione të tjera, siguron drejtimin ekonomik-financiar të degëve rajonale, siguron zbatimin dhe kontrollin e zbatimit të akteve ligjore e nënligjore, që rregullojnë veprimtarinë në fushën e rezervave materiale të shtetit, etj.

Lidhur me veprimtarinë e kryer DPRMSH duhet të informoj periodikisht ministrin, Këshillin e Ministrave dhe kur i kërkohet Komitetin Ndërmnistror të Emergjencave Civile, për gjendjen e mallrave rezervë materiale të shtetit.

Monitorimi dhe raportimi i aktivitetit

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave të Shtetit ka hartuar në Qershor 2022 një dokument Raport-analizë të punës së institucionit e cila përfshin aktivitetin për periudhën vitet 2018-2021. Ky është dokument i vetëm përmbledhës për 4 vite të aktivitetit, i cili është përcjellë pranë strukturave brenda institucionit si edhe Drejtorive Rajonale, e megjithatë ai nuk rezulton i dërguar pranë Ministrisë së Mbrojtjes. Informacionet që përcillen nga DPRMSH janë kryesisht raportime përmbledhëse mbi mallrat e shpërndara në rastet e fatkeqësive natyrore pas kërkesave të Prefekturave të Qarkut, informacione mbi ankandet e zhvilluara, informacione periodike mbi gjendjen e inventarizimit dhe regjistrimit të pronave nën përgjegjësi administrimi referuar kërkesës nr. 1004 prot, datë 24.02.2022 të Ministrisë së Mbrojtjes, raportimet 4-mujore mbi realizimin e buxhetit, mbi burimet njerëzore të disponueshme etj. Këto raportime kanë një mënyrë standarde si informacioni pasqyrohet. Ato hartohen nga njësi të veçanta në DPRMSH dhe u drejtohen strukturave përkatëse në ministri ndërkohë për vlerësimin e ecurinë e institucionit nga menaxhimi nuk ka një raportim periodik, ku të listohet aktiviteti i njësisë për të evidentuar ecurinë, nevojat si dhe mangësitë gjatë ushtrimit të veprimtarisë.

Sa i përket garantimit të funksionimit efektiv të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit njësia e auditimit të brendshëm në DPRMSH ka zhvilluar në mënyrë të vazhdueshme misionet e auditimit pranë Drejtorive Rajonale në të cilat ka lënë rekomandimet përkatëse ndërkohë që Drejtoria e Përgjithshme nuk rezulton e audituar nga kjo njësi auditimi.

Po kështu, nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes është kryer vetëm një mision inspektimi në fillim të vitit 2019 sipas planit të Punës nr. 274/1 prot, datë 15.01.2019 për rezervën materiale të shtetit, ndërkohë për aktivitetin e periudhës vitet 2019 -2022 nuk rezultojnë inspektime të kryera.

Procesi i koordinimit në buxhetimin për rezervën materiale

Rezervat materiale të shtetit administrohen nga ministri nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit, e cila është institucion qendror që financohet nga buxheti i shtetit. Si e tillë veprimtaria e institucionet i nënshtrohet disiplinës buxhetore parashikuar nga ligji për nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”. Institucioni deri në fillim të vitit 2018 ka qenë në varësi të Ministrisë së Brendshme dhe me VKM nr.9 datë 21.01.2018, “Për një ndryshim në Vendimin nr. 501, datë 13.09.2017 të Këshillit të

Ministrave”, ka kaluar brenda fushës së përgjegjësive të Ministrisë së Mbrojtjes. Kjo fushë përgjegjësie është ri-përcaktuar me VKM nr. 605 datë 20.10.2021.

Deri përpara këtij kalimi Rezerva Materiale e Shtetit, paraqitej në Tabelën nr.1 e cila shoqëron ligjin vjetor të buxhetit, si pjesë e Ministrisë së Brendshme me programin buxhetor nr. 01180 “Menaxhimi i Rezervave Materiale të Shtetit” si dhe me disa njësi shpenzuese, drejtorinë e përgjithshme dhe drejtoritë rajonale të saj. Prej vitit 2018 dhe në vijim ky program buxhetor nuk figuron por veprimtaria e saj tashmë përfshihet brenda Ministrisë së Mbrojtjes në kodin buxhetor nr.10910 “Emergjencat civile”, ku drejtues i këtij programi është në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile. Si njësi shpenzuese për rezervën materiale të shtetit ka mbetur vetëm drejtoria e përgjithshme pra procesi aktualisht është plotësisht i qendëruar.

DPRMSH për disa vite rresht ka ngritur grupin e Ekipit të Menaxhimit të Projekteve dhe planifikimin buxhetor referuar udhëzuesve plotësues të Ministrisë së Mbrojtjes dhe ka paraqitur planifikimet buxhetore pranë Drejtuesit të EMP në AKMC dhe është ky i fundit i cili raporton në nivel programi pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mbrojtjes. Në vitin 2022 nga Drejtori i Përgjithshëm i AKMC në rolin e drejtuesit të programit është ngritur EMP me përbërje të përbashkët por edhe në këtë rast pjesëmarrja në numër është e pa balancuar, 5 anëtarë nga AKMC dhe 3 nga DPRMSH. Veç pjesëmarrjes, puna e këtij grupi nuk gjendej e dokumentuar në DPRMSH për të evidentuar efektivitetin e tij në buxhetim, ndërsa Ministria e Mbrojtjes mungonte në këtë rast në rolin e koordinatorit mes institucioneve të varësisë.

Duke qenë se për të njëjtin program buxhetor planifikojnë njëkohësisht dy institucione duke mos pasur një ndarje qartë të tavaneve buxhetore nga Ministria e Mbrojtjes por as mes tyre, krijon risk për një planifikim jo të përshtatshëm të kërkesave buxhetore.

Nëse i referohemi nenit 3 “Përdorimi”, të ligjit nr. 9900 datë 10.04.2008 “Për rezervën materiale të shtetit”, i ndryshuar, përcaktohet se rezerva materiale e shtetit krijohet për të ndërhyrë në mënyrë operative, për mbrojtjen e popullsisë, të ekonomisë dhe mbrojtjen e vendit, në situata të gjendjes së jashtëzakonshme, gjendjes së emergjencës civile, veprimeve terroriste, veprimeve ushtarake (në gjendje lufte) të cilat sjellin dëme të menjëhershme e të rënda për jetën, për shëndetin e popullatës dhe gjësë së gjallë, për pasurinë, trashëgiminë kulturore dhe për mjedisin. Situata e përbashkët të emergjencave civile është vetëm një nga aspektet që rezerva materiale e shtetit duhet të përmbush për vendin dhe për këtë arsye ndryshimet e ndodhura e kanë vendosur në një pozicion jo të përshtatshëm sa i përket buxhetimit të veprimtarisë së saj.

Gjithashtu kalimi i drejtorive rajonale nga njësi shpenzuese më vete nën kodin buxhetor të drejtorisë së përgjithshme ka krijuar vështirësi në veprimtarinë e përditshme të këtyre institucioneve pasi ato duhet të drejtohen në qendrën në Tiranë edhe për plotësim të nevojave elementare ndërkohë që largësia e tyre për të plotësuar nevojat është e konsiderueshme dhe kostot e lëvizjes janë të larta.

Bashkëveprimet në rastin e emergjencave civile

Rezerva materiale e shtetit është institucion i cili vihet në lëvizje në raste jo të zakonshme. Kërkesat për mallra nga rezerva materiale e shtetit në rastin e emergjencave civile nisin nga kërkesat e drejtuesve vendorë të cilët i drejtohen prefektit të qarkut përkatës. Ky i fundit i drejtohet Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile e cila luan një rol qendror për koordinimin e këtyre situatave. Më tej AKMC drejtohet me kërkesë në Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit e cila në referuar përgjegjësive që ligji përcakton për lëvrimin e mallrave të rezervës materiale vepron ose përcjell për vendimmarrje sipas rastit:

-Lëvrimi i mallrave rezervë të grupit A bëhet me vendim të Kryeministrit dhe propozim të Ministrit,

-Lëvrimi i mallrave rezervë të grupit B bëhet me urdhër të Ministrit dhe propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të Rezervave Materiale të Shtetit,

-Mallrat rezervë të grupit C lëvrohen me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Rezervave Materiale të Shtetit:

Në përfundim të vendimmarrjes njoftohet prefekti i qarkut dhe bashkia përkatëse për tërheqjen e mallrave dhe dorëzimin e dokumentacionit për konfirmim-marrjet e mallrave pranë drejtorisë rajonale së ngarkuar për zbatimin e vendimit/urdhrit.

Mekanizmi aktual i përgjigjes ndaj qytetarit përbëhet nga disa institucione, të cilat kërkojnë kohë e nevojshme për tu përgjigjur, ndërkohë që reagimi ndaj situatës nevojitet të jetë i menjëhershëm. Në këto kushte rrishtet që ky procedurat të mos plotësohen sipas përcaktimeve ose që plotësimi i tyre të kthehet në formalitet. Mënyra e përgjigjes ndaj situatave të emergjencës evidenton nevojën për vlerësimin drejt një qasje të orientuar sa më pranë qytetarit.

1. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit për periudhën nën auditim, vitet 2019-2022, nuk ka të përcaktuar në aktet e veta rregullative një formë të mirë përcaktuar raportimi nga drejtoritë rajonale në DPRMSH dhe nga kjo e fundit në Ministrinë e Mbrojtjes. Informacionet e dërguara nga gjatë kësaj periudhe drejt institucionit epror janë kryesisht raportime të rregulluara nga akte të tjera ligjore si në rastin e raportimeve buxhetore, të ankandëve, burimeve njerëzore si dhe të dhënave të kërkuara specifikisht për aktivitetin. Në këtë periudhë 4-vjeçare është hartuar vetëm një Raport-analizë për aktivitetin e kryer përkatësisht vitin 2022, por edhe ky raport rezulton i dërguar drejt Drejtorive Rajonale dhe jo pranë Ministrisë së Mbrojtjes. Mungesa e një sistemi të qartë raportimi ndikon në menaxhimin efektiv të burimeve.

1.1 Rekomandimi: Ministria e Mbrojtjes dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit, të rishikojnë, aktet e brendshme rregullatorë mbi raportimin e aktivitetit vjetor të institucionit të rezervave materiale të shtetit duke saktësuar mënyrën e raportimit të drejtorisë qendrore dhe atyre vendore si dhe frekuencën e tyre.

Brenda vitit 2023

2. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit nuk rezulton të jetë audituar nga Njësisë e Auditimit të Brendshëm, pjesë e strukturës së saj, për veprimtarinë e kryer për periudhën nën auditim. Kjo strukturë nuk ka qenë as objekt i inspektimeve nga Ministria e Mbrojtjes, megjithëse është njësi kryesore për administrimin e rezervës materiale të shtetit dhe kryen menaxhimin financiar të gjithë strukturës nën varësi, çka nuk jep siguri të arsyeshme për funksionalitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe garantimin e përdorimit me efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet të fondeve publike dhe burimeve institucionale.

2.1 Rekomandimi: Ministria e Mbrojtjes dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit, të kryejnë përkatësisht, inspektime dhe auditime të plota në drejtorinë qendrore të rezervave materiale të shtetit, për të vlerësuar aktivitetin e kryer si dhe funksionimin e sistemeve të kontrollit të kësaj njësie.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Kalimi i rezervave materiale të shtetit, në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes solli dhe vendosjen e saj nën të njëjtin program buxhetor me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, njësi gjithashtu nën varësi të Ministrisë së Mbrojtjes e cila është ngarkuar me drejtimin e këtij programi. Pas këtyre ndryshimeve, drejtoritë rajonale të rezervës materiale u suprimuan si njësi shpenzuese dhe procesi u qendërua në Drejtorinë e Përgjithshme. Referuar fushës së saj të përgjegjësisë, përballimi i emergjencave civile është vetëm një nga aspektet që rezerva materiale e shtetit duhet të përmbush për vendin por ndryshimet e ndodhura e kanë vendosur në një pozicion jo

të përshtatshëm sa i përket buxhetimit dhe menaxhimit të aktivitetit por dhe të institucioneve të varësisë të saj.

3.1 Rekomandimi: Ministria e Mbrojtjes në rolin e institucionit epror, të vlerësojë nevojën dhe të ndërmarrë iniciativat e nevojshme për kalimin e rezervës materiale nën një kod buxhetor më vete.

Brenda vitit 2023

Konkluzione:

1. Sistemi i raportimit dhe monitorimit dhe koordinimit mes institucioneve paraqet mangësi dhe evidenton nevoja për përmirësim, në drejtim të, raportimeve vjetore mbi aktivitetin, kryerjen e auditimeve dhe inspektimeve periodike për të dhënë siguri mbi efektivitetin e sistemeve të kontrollit të brendshëm të institucionit, si dhe nevojës për koordinim më efektive në drejtim të përgjigjes së shpejtë ndaj qytetarit.

2. Vendosja nën njëjtin program buxhetor të dy institucione duke mos pasur një ndarje qartë të tavaneve buxhetore nga Ministria e Mbrojtjes por as mes tyre, krijon risk për mungesë koordinimi, dhe një planifikim jo të përshtatshëm të kërkesave buxhetore. Ndërkohë që qendërzimi i plotë i veprimtarisë financiare ka ndikime negative në aktivitetin e përditshëm të njësisve rajonale.

Trajtimi i komenteve nga subjektet e audituara

Pas marrjes së Projekt Raportit të Auditimit, Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit nëpërmjet shkresës nr. 59/8 prot, datë 03.07.2023, administruar në KLSH me nr. 1180/6 prot, datë 04.07.2023 ka trajtuar gjetjet dhe rekomandimet e përcjella. Komentet e paraqitura nga DPRMSH në shkresë pasqyrojnë masat e marra në zbatim të rekomandimeve të lëna dhe nuk përmbajnë observime mbi përmbajtjen e gjetjeve dhe rekomandimeve.

4. PËRMBLEDHJE

Disa nga problematikat e trajtuara në këtë auditim janë: Ministria e Mbrojtjes si institucion përgjegjës për hartimin e politikave shtetërore të sigurisë dhe mbrojtjes së vendit nuk ka përfshirë në dokumentet politikë (strategji kombëtare/sectoriale, direktivat e ministrisë për mbrojtjen civile etj., rezervën materiale të shtetit duke mos garantuar në këtë mënyrë një vizion të qartë lidhur me administrimin e saj.

Kuadri ligjor dhe rregullator i rezervës materiale të shtetit është i pa përditësuar, duke shkaktuar mbivendosje dhe role të paqarta mes institucioneve të përfshira gjatë ndërhyrjes në përballimin e situatave të parashikuara sipas përcaktimit ligjor.

Organizimi dhe funksionimi i DPRMSH-së dhe drejtorive rajonale nuk është kryer sipas një analize të thelluar referuar kosto përfitim, nevojave për burime njerëzore me aftësi profesionale specifike gjykuar nga rëndësia dhe veçoritë e RMSH, objektivave strategjike afatgjatë lidhur me aktivitetin e me shkriren e disa agjencive dhe efekteve pozitive të qendërzimit të tyre, ku kjo e fundit mbart dhe vështirëson më shumë procesin e regjistrimit të aseteve të tyre, etj. Ndryshimet në strukturat janë bërë të parashikuara me zhvillimet e fundit ligjore në fushën e mbrojtjes civile, gjë e cila vështirëson shumë aktivitetin e këtyre drejtorive. Pozicionet e drejtuesve të drejtorive rajonale me emërim të përkohshëm ose të komanduar, ndryshimet e shpeshta dhe pozicioni i Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit për periudhën 2019 e ne vazhdim i komanduar, bartin risk të lartë për menaxhimin e rezervës materiale të shtetit. Institucionet e përfshira pavarësisht kohës së gjatë nuk kanë arritur të përmbushin detyrimin për regjistrimin e plotë të pronave, pavarësisht se ka një vendim të Këshillit të Ministrave i cili ngarkon institucionet respektive për regjistrimin e tyre. Nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit nuk ka qartësi mbi mënyrën se si do të

administrohen pasuritë e paluajtshme të rezervave materiale. Kryerja e aktivitetit dytësor për ruajtjen dhe shitjen e mallrave të sekuestruara dhe konfiskuara evidenton nevojën për rishikim të përgjithshëm të veprimtarisë së rezervës materiale, për të mos lënë hapësira në përmbushjen e aktivitetit kryesor të rezervës materiale të shtetit. Së fundi, territori dhe ndërtesat e njësisë kryesore të rezervës materiale me vendndodhje në Lundër, Tiranë, e cila është përgjegjëse për administrimin e mallrave ushqimorë në rang kombëtar, me VKM nr. 808, datë 12.12.2022 i kanë kaluar në përgjegjësi administrimi Fondit Shqiptar të Zhvillimit, me qëllim ngritjen e një kompleksi argëtues dhe sportiv. Deri në këtë fazë nuk disponohej një plan zhvendosje dhe një projekt të miratuar për zonën i cili referuar vendimit të sipërcituar duhet të ishte i dakordësuar më parë mes palëve. Pavarësisht sa më sipër, procedura për zhvendosjen ka nisur prej muajit Shkurt 2023 por ende nuk ka gjetur zbatim. Mungesa e qartësisë në vendimmarrjet e kryera lidhur me asetet ka ndikime negative në mirë administrimin e aktivitetit të institucionit.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT